

VENDIM
Nr. 1139, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SIGURISË NË KOMUNITET 2021 – 2026 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021 – 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimit 2021 – 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E SIGURISË NË KOMUNITET
2021 – 2026

PËRMBAJTJA

PËRKUFIZIME

PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike
3. Arritjet, Analiza dhe Sfidat
4. Vizioni dhe misioni
5. Metodologjia

PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

POLITIKA 1 – RRITJA E PARAMETRAVE TË SIGURISË NË KOMUNITET

Objektivi specifik 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin

Objektivi specifik 1.2: Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet

Objektivi specifik 1.3: Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit

POLITIKA 2 – ANGAZHIMI DHE NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN

Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve

Objektivi specifik 2.3: Rritja e mbështetjes së njësisve të vetëqeverisjes vendore për publike

POLITIKA 3 – REFORMIMI I SHËRBIMIT POLICOR DHE RRITJA E KAPACITETEVE PËR SIGURINË NË KOMUNITET

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për Policimin në Komunitet

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë

PJESA III – MASA PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË

PJESA IV – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE

4.2 LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

PJESA V – BUXHETI

ANEKSI 1. PLANI I VEPRIMIT 2021 – 2023

ANEKSI 2. PASAPORTA E INDIKATORËVE

SHKURTIME

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
BE	Bashkimi Evropian
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPK	Departamenti i Policisë Kriminale
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
DSHM	Departamenti për Shërbimet Mbështetëse
DMN	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DSP	Departamenti për Sigurinë Publike
DVP	Drejtoria Vendore të Policisë
KVSP	Këshilli Vendor për Sigurinë Publike
MB	Ministria e Brendshme
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSPK/SPZ	Ndihmës Specialist i Policimit në Komunitet
PK	Policimi në Komunitet
PSH	Policia e Shtetit
QEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
SCPA	Mbështetja e Qeverisë Suedeze për MB/DPPSH për forcimin e sigurisë në komunitet në Shqipëri
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ZP	Zona Policore
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

PËRKUFIZIME

Policim në Komunitet: Policimi në komunitet (PK) është një filozofi dhe strategji organizative e të vepruarit që fokusohet në krijimin e lidhjeve me komunitetin dhe i lejon policisë të punojë ngushtësisht me anëtarët e komunitetit, për të zgjidhur problemet e rendit dhe çështjet e sigurisë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së gjithsecilit në komunitet;

Siguria e Komunitetit: Përdorimi i aftësive, njohurive dhe teknikave për të parandaluar dhe reduktuar kriminalitetin, për të fuqizuar sigurinë njerëzore dhe për zhvillimin e komuniteteve të sigurta në Shqipëri, përmes partneriteteve efikase dhe të qëndrueshme midis qytetarëve dhe institucioneve duke garantuar “lirinë nga frika” dhe “lirinë nga nevoja” të qytetarëve;

Komunitet/publik: Një term i gjerë që identifikon bashkësi njerëzish të cilët bashkëjetojnë në të njëjtën qendër banimi ose që kanë interesa të përbashkëta të të jetuarit, si: puna, shoqëria, bashkëjetesa e gjerë pa dallim etnie, race, feje, gjinie etj. Komuniteti/publiku përfshin gjithashtu bashkësi sociale si: grupet etnike, grupet e biznesit, organizatat kombëtare etj.;

Policia e Shtetit: Shërbim publik që përgjigjet për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private, parandalimin dhe zbulimin e krimit, zvogëlimin e frikës dhe dhënien e ndihmës për publikun;

Partneritet qeveri – publik: Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare, duke përfshirë edhe autoritetet e njëjësive të qeverisjes vendore, ndërmarrjet e shërbimit, bizneset e ndryshme, OJF etj., të cilët punojnë së bashku dhe shkëmbejnë burimet dhe ekspertizën e tyre me qëllim që të evidentojnë problemet, të vendosin prioritetet, dhe t'i zgjidhin këto probleme në mënyrë afatgjatë, duke luftuar shkaqet, si edhe pasojat;

Llogaridhënie e policisë: Proces pune, ku strukturat shtetërore dhe pushteti vendor raportojnë për zbatimin e detyrave të saj, para strukturave eprorë, strukturave të institucioneve të tjera dhe para publikut. Llogaridhënia tregon se veprimtaria e policisë është e hapur për vëzhgim nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse, përfshirë dhe publikun;

Parandalimi i krimit: Identifikimi i individëve ose komuniteteve në rrezik dhe ndërhyrja për të zvogëluar faktorët e rrezikut dhe/ose për të rritur faktorët mbrojtës;

Sjelljet antishoqërore: Janë veprime që dëmtojnë mirëqenien e të tjerëve ose çdo lloj sjellje që shkel të drejtat themelore të një personi tjetër dhe çdo sjellje që konsiderohet përçarëse ndaj të tjerëve në shoqëri.

PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 vjen si nevojë e rinovimit të Strategjisë së Rendit dhe Sigurisë Publike 2015 – 2020, dokumentit për Policimin në Komunitet 2018 – 2020, si dhe e një sërë strategjish dhe plan veprimesh të ndryshme të lidhura me çështje të sigurisë në komunitet, të cilat kanë përfunduar ose përfundojnë në vitin 2020.


Me fillimin dhe implementimin e procesit të decentralizimit, si dhe konceptit të sigurisë në komunitet, siguria publike tashmë ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit. Ky ridimensionim i ri i shërbimeve të të gjithë aktorëve në lidhje me sigurinë lidhet me zhvillimin e vendit në përgjithësi, si dhe me agjendës zhvillimore drejt anëtarësimit në BE. Kjo qasje e re do të materializohet në Strategjinë e re Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, me anë të së cilës siguria në komunitet është përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë, që aplikohet në mënyrë demokratike dhe në përputhje me standardet dhe eksperiencat më të mira perëndimore.

Ky ridimensionim do të sjellë një gjithëpërfshirje të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, të cilat kanë detyrimin ligjor për garantimin e sigurisë në komunitet. Në këtë mënyrë, siguria publike nuk do të jetë më kompetencë vetëm e Policisë së Shtetit, duke shfrytëzuar qasjen e deritanishme vertikale në garantimin e rendit dhe sigurisë, por ky koncept tashmë do të jetë më demokratik dhe në rrafshin horizontal, duke bërë bashkë të gjithë aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë, institucionet ligjzbatuese, Policinë e Shtetit, qytetarët dhe komunitet, institucionet e tjera joqeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare, mediat etj., për të krijuar një kulturë të re të sigurisë publike.

Strategjia identifikon qartë përparësitë nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjike kombëtarë dhe përshkruan parimet udhëzuese që do të mbështesin përpjekjet ndërsektoriale për të siguruar sigurinë e publikut. Gjithashtu, kjo strategji, në planin e veprimit, siguron një organizim unikues për të gjitha njësitë e qeverisjes dhe identifikon masa specifike për të drejtuar përparësitë tona kombëtare afatshkurtra për sigurinë e komunitetit dhe për të informuar procesin e alokimit të burimeve. Më e rëndësishmja, ajo krijon një themel për ndërtimin dhe nxitjen e mjedisit bashkëpunues në të cilin qeveria dhe qytetarët dhe komuniteti mund të kryejnë përgjegjësitë e tyre përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes në mënyrë më efektive.

Skema e mëposhtme paraqet vizionin e strategjisë, bazuar në objektivat e dokumenteve strategjike, të përmendur në seksionin 2, të këtij dokumenti, si prioritetet e përcaktuara nga

analiza e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe analiza të tjera në të cilat janë përcaktuar tri politikat për vitet 2021 – 2026.



2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e sigurisë publike. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, krijimi i kushteve për një jetë më të sigurt për qytetarët, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për fuqizimin e sigurisë publike, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me qytetarët në këtë drejtim.

Kuadri ligjor për sigurinë publike është i gjerë dhe përfshin një tërësi ligjesh, aktesh nënligjore, që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore për këtë fushë, të tilla si:

- ligji nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;

- ligji nr. 103/2014, datë 31.7.2014, “Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”;

- ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;

- projektligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;

- ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018 dhe nr. 125/2020;

- ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

- ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” etj.

Ky dokument strategjik është i ndërlidhur, kontribuon dhe është bazuar në parimet që rrjedhin nga këto dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, si më poshtë:

- programi qeverisës për periudhën 2017 – 2021;

- **lidhja me PKIE-n dhe legjislacionin e BE-së (kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria, nënkapitulli: Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar).** Kjo strategji nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* të BE, për fushën e rendit dhe sigurisë publike;

- dokumenti për Policimin në Komunitet dhe Plan i Veprimit 2018 – 2020, miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 654, datë 10.12.2018;

- programi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 632, datë 27.1.2020, për zbatimin e dokumentit të Policimit në Komunitet;

- “Strategjia e Rendit Publik dhe Planit të Veprimit, 2015 – 2020”;

- “Plani Kombëtar Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, 2018 – 2020”, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 313, datë 31.5.2018;

- “Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013 – 2020” dhe plani i veprimit operacional;

- “Strategjia Ndërsektoriale për decentralizimin dhe vetëqeverisjen vendore, 2015 – 2020” (VKM-ja nr. 691, datë 29.7.2015);

- rekomandimet e KE-së;

- “Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2011 – 2020”, miratuar me VKM-n nr. 125, datë 23.2.2011;

- “Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”, miratuar me VKM-n nr. 930, datë 18.11.2015;

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,

- Konventa për të Drejtat e Njeriut,

- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve,

- Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar);

- Karta Evropiane e Autonomisë Lokale etj.

Politikat dhe objektivat specifike të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Plan i Veprimit 2021 – 2023, janë gjithashtu në përputhje me disa prej **Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe Agjendës 2030, respektivisht:**

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe; 3.6 të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i plagosjeve nga aksidentet rrugore.

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave; 5.1 T’i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave; 5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit; 5.3 Të eliminohen të gjitha praktikat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme dhe martesat e detyruara dhe gjymtimi gjenital femëror; 5.5 Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.

Objektivi 11: Ndërtimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të parrezikshme, rezistente dhe të qëndrueshme; 11.2 Të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve; 11.5 Të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur; 11.6 Të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.

Objektivi 16: Paqe, drejtësi, institucione të forta; 16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës; 16.6 Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet; 16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare; 16.a Të fuqizohen institucionet përkatëse kombëtare, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

Arritjet

Situata e sigurisë dhe e rendit publik në vend është përmirësuar rrënjësisht në katër vitet e fundit. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë ata që jetojnë në territorin e saj, për jetën, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Në fokus të Planit të Veprimit 2018 – 2020, të Strategjisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, 2015 – 2020 ka qenë ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme, ndërveprimit dhe besimit ndërmjet komunitetit dhe policisë. Në këtë kuadër u finalizua një strategji gjithëpërfshirëse ndërsektoriale për sigurinë në komunitet, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Zbatimi i kësaj strategjie u konkretizua dhe me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë në Komunitet.

Forcimit të policimit në komunitet po i shërbejnë edhe politikat gjithëpërfshirëse në këtë drejtim, të Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme, si dhe ndihma e donatorëve të ndryshëm nëpërmjet programeve mbështetëse. Programi Suedezi “Forcimi i Policimit në Komunitet” (SCPA) ka qenë një partner kyç i cili ka nxitur këtë proces. Pas ndryshimeve strukturore të miratuara, janë krijuar dhe funksionojnë strukturat për policimin në komunitet në nivel qendror dhe vendor (sektorët dhe seksionet e policimit në komunitet).

Në këtë drejtim, me miratimin e akteve të ndryshme nënligjore, si urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, janë miratuar përmes asistencës së SCPA-së, përshkrimet e reja të punës së Ndihmës Specialistëve të Policimit në Komunitet (NSPK), është krijuar struktura e NSPK-së për edukimin në institucionet arsimore parauniversitare, të cilët janë trajnuar dhe asistuar në punën e tyre nga SCPA-ja. Gjithashtu asistenca e SCPA-së ka qenë e rëndësishme për rishikimin dhe përshkrimin e ri të punës, të miratuar për Patrullën e Përgjithshme.

Në këtë kuadër, Programi ka kontribuar gjithashtu për **fuqizimin e filozofisë së policimit në komunitet në Shqipëri** përmes një sërë nismave me të rinjtë.

Një prej prioriteteve, në drejtim të ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme, ndërveprimit dhe fuqizimit të besimit të komunitetit në Policinë e Shtetit, ka qenë vënia në eficiencë të plotë e zonave policore. Policia e Shtetit, me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë është angazhuar për vënien në eficiencë të plotë të Zonave Policore, për t'i transformuar në mekanizmat kyç dhe efikas të filozofisë së policimit në komunitet. Për këtë, po punohet me asistencën e Programit Suedezi të Policimit në Komunitet, në DVP pilot të Elbasanit, për zbatimin dhe implementimin e detyrave të reja të NSPK-ve dhe Patrullës së Policisë sipas zonave policore.

Në fokus të Planit të Veprimit 2018 – 2020 ka qenë dhe **rritja e ndërgjegjësimit të publikut për parandalimin e veprave penale të lehta dhe sjelljeve antishoqërore**. Kjo është realizuar nëpërmjet intensifikimit të programeve të edukimit publik në institucione arsimore parauniversitare përmes bashkëpunimit efektiv me institucionet e arsimit dhe organizatat e shoqërisë civile. Janë zhvilluar një sërë fushatash ndërgjegjësuere në lidhje me parandalimin e veprave penale dhe sjelljeve antishoqërore, veçanërisht radikalizmit dhe përfshirjes në krime të të miturve dhe të rinjve, si dhe takime në institucionet arsimore parauniversitare me nxënës e studentë për informimin lidhur me pasojat nga përfshirja në veprimtari kriminale, si dhe janë shpërndarë materiale ndërgjegjësuere të përshtatura sipas fokus grupeve të veçanta. Gjithashtu, me punonjësit e policisë, të caktuar për zbatimin e këtij programi, janë zhvilluar trajnime për programin sensibilizues dhe për sigurinë rrugore.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së procesit të organizimit, funksionimit dhe fushës së veprimit të policimit vullnetar. Për implementimin në praktikë të policimit vullnetar është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 641, datë 2.10.2019, **“Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar”**, si dhe urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1403, datë 19.11.2019, për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e këtyre akteve nënligjore, gjatë periudhës janar – mars 2020.

Reformimi i strukturave dhe funksionimit të Policisë së Shtetit me fokus në reformën e personelit, rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin në kohë të informacionit policor, mbështetjes logjistike dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit të publikut, si dhe përmirësimet në drejtim të transparencës, digjitalizimit të shërbimeve të policisë, shërbimit ndaj qytetarit, si dhe trajtimit financiar, ekonomik dhe logjistik konsiderohen arritje të dukshme dhe të prekshme.

Organizimi i ri i Policisë së Shtetit synoi ristrukturimin dhe **konsolidimin e vazhdueshëm të të gjithë sistemit duke thjeshtuar strukturat, ridimensionuar përgjegjësitë** për çdo funksion e pozicion pune, duke shtuar ngarkesën e punës dhe fuqizuar kompetencat, duke përmirësuar raportet dhe procedurat standarde të punës, duke rivlerësuar personelin sipas vlerave dhe meritokracisë së punonjësve, si dhe duke ngritur mekanizma që garantojnë komunikimin e bashkëpunimin ndërinstitucional efektiv me aktorët e tjerë të sigurisë.

Në këtë kuadër, ndryshimet organizative të realizuara janë fokusuar në:

- Modelimin dhe fuqizimin e njërive vendore (komisariateve/stacioneve të Policisë), duke u ngarkuar të gjithë përgjegjësinë për kontrollin e territorit, mbrojtjen e zbatimit të ligjit dhe luftën kundër krimit, si dhe duke kompletuar strukturat me kapacitet e nevojshme për kryerjen e detyrave;

- Riformatimin e strukturave dhe shërbimeve policore përgjegjëse që do të ndjekin drejtime e forma të veçanta të krimit, nga niveli i drejtorisë së policisë vendore deri te strukturat qendrore, të përgjegjëse, raporteve dhe procedurave të punës së tyre;

- Organizimin e strukturave të veçanta për të ndjekur disa forma të veçanta të krimit (vrasjet, veprat terroriste, trafiket, drogat, pastrimi i parasë, krimi kompjuterik, korrupsioni nga funksionarët e lartë, etj.), të cilat kanë veçori e vështirësi për t'u zbuluar e dokumentuar, duke përdorur parimet profesionale dhe përvojën e vendeve perëndimore.


Në fokus ka qenë **formimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë**, ku një ndihmesë të veçantë ka dhënë vënia në funksionim të plotë e Akademisë së Sigurisë (AS) së Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër janë realizuar një sërë masash, duke miratuar akte nënligjore si: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015, **“Për organizimin dhe funksionimin e AS”**; Statuti i Akademisë së Sigurisë me urdhrin e përbashkët nr. 490, datë 21.9.2015, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe ministri i Brendshëm etj.

Për zhvillimin e personelit akademik, të aftë për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri bashkëkohore të fushës së policimit dhe sigurisë publike, në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, janë kryer si më poshtë:

- përcaktimi i procedurave të rekrutimit të personelit akademik në **“Rregulloren e Akademisë së Sigurisë”**, në zbatim të LAL;

- përfundimi i aplikacionit për aplikimet për punësim në Akademinë e Sigurisë, që mundëson miradministrimin e procesit të punësimit të studentëve ekselentë;
- përmirësimi i sistemit të librarisë elektronike me funksionalitete shtesë.

Për zhvillimin profesional e akademik të personelit trajnues dhe mësimdhënës të Akademisë, janë zhvilluar një numër trajnimesh, si dhe janë ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi për shkëmbimin e përvojave mësimdhënëse me Universitetin e Tiranës (1 trajnim, 20 pjesëmarrës) dhe Aleancën Franceze (1 trajnim me 22 pjesëmarrës nga stafi akademik). Rekrutimi i personelit mësimdhënës bazohet në ligjin për Arsimin e Lartë, ligjin e Policisë së Shtetit dhe “Rregulloren e Akademisë”.



Grafiku 1: Kurse për oficerët e trajnimit në terren

Gjithashtu, **arritje janë shënuar në drejtim edhe të rritjes së kapaciteteve operacionale dhe drejtuese** të Policisë së Shtetit, nëpërmjet specializimeve sipas fushave të veprimtarisë policore, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit efektiv me institucionet e tjera të arsimit të lartë publik dhe jopublik, me organizma ndërkombëtarë këshillues të PSH-së (ICITAP dhe PAMECA), janë ndërmarrë një sërë nismash si:

- nënshkrimi i marrëveshjes me Akademinë e Forcave të Armatosura të RSH-së, për shkëmbim eksperiencash në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor (2017);
- nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit apo memorandumeve të mirëkuptimit të Akademisë së Sigurisë me Akademitë e Sigurisë së Austrisë, Hungarisë, CEPOL, Malit të Zi, FRONTEX, Kosovës, Estonisë etj.;
- anëtarësimi në shoqatën ndërkombëtare të drejtorëve të akademive “IADLEST” me qendër në SHBA, për standardet e trajnimit;
- anëtarësimi në Shoqatën e Kolegjeve të Policisë Evropiane (AEPC);
- fuqizimi i bashkëpunimit me akademitë e vendeve të rajonit në fushën e kërkimit shkencor me pjesëmarrje dhe referime të ndërsjella në konferencat shkencore për tematika të ndryshme policore;
- botimi periodik i revistës shkencore policore “Policimi dhe siguria”.


Në kuadër të ofrimit të sigurisë publike, për implementimin e plotë të ligjit “Për masat shtesë të sigurisë”, është ndjekur procesi për miratimin e akteve nënligjore, si më poshtë:

- VKM-ja “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis administratorëve të ndërtesave të banimit, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit”;
- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për ngritjen dhe funksionimin e një regjistri, si bazë të dhënash qendrore apo vendore, në të cilën regjistrohen subjektet që sipas ligjit, marrin masa shtesë të sigurisë publike”.

Gjithashtu, janë bërë përpjekje për **përafrimin e legjislacionit dhe organizimit të policisë me atë të BE-së**, duke u fokusuar në ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në legjislacion,

akte nënligjore, organizim dhe funksionim të policisë, për ta përshtatur atë më mirë me faktorët e mjedisit e nevojat e komunitetit dhe përafruar me standardet e shërbimit policor të BE-së.

Gjatë viteve 2018 – 2020, masat u fokusuan në **ndryshimin cilësor të sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet, në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit**, i cili paraqitet si më poshtë:



Analiza në nivel vendor

Çështjet e sigurisë publike aktualisht trajtohen në rrafshin vertikal, ku aktori i vetëm “*de facto*” përgjegjës për garantimin e tij është Policia e Shtetit. Ky fakt ka sjellë një mbingarkesë në zbatimin e detyrimeve nga ana e Policisë së Shtetit, si dhe një problematikë tjetër që lidhet me mosfunksionimin adekuat të këshillave vendorë të sigurisë publike, të cilët shërbejnë si mekanizëm i mirëfilltë konsultimi dhe vendimmarrje për çështjet e sigurisë në nivel vendor. Fuqizimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë është një faktor kyç në rritjen e efikasitetit të institucioneve qendrore dhe vendore në parandalimin dhe trajtimin e kriminalitetit, dhunës, bulizmit, diskriminimit, ngacmimeve dhe fenomeneve të tjerë problematike për qytetarët.

Një prej risive më të mëdha në nivel vendor për fuqizimin e sigurisë publike kanë qenë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP). Këto struktura janë ngritur bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Mbi vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Strategjinë Kombëtare të Rendit Publik (2015 – 2020), Strategjinë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, si dhe në aktet përkatëse nënligjore. Këshillat kanë filluar të krijohen në fund të vitit 2016, fillimisht në bashkitë e Elbasanit dhe Librazhdit.

Aktualisht, falë mbështetjes së vazhdueshme të OSBE-së, Komisionit Evropian, USAID-it, SIDA-s dhe Ambasadës Holandeze, KVSP-të janë ngritur në disa bashki të vendit, por jo të gjitha funksionojnë apo kryejnë veprimtari rregullisht. Procesi i ngritjes së KVSP-ve në Shqipëri nuk është shoqëruar me akte ligjore ose nënligjore dhe nuk ka zyra ose zyrtarë të ngarkuar me përgjegjësi, si në nivel shtetëror ashtu dhe në nivel vendor. Në mungesë të kuadrit rregullues, bashkitë kanë përshtatur rregulloret që u janë prezantuar nga organizatat e ndryshme mbështetëse (shiko më sipër). Në shumë bashki, rregulloret janë miratuar nga kryetarët e bashkive, në disa nga vetë KVSP-të dhe në disa raste janë miratuar nga këshilli bashkiak. Rregulloret marrin referenca nga ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 108/2015, “Për Policinë e Shtetit”,

sidoqoftë, asnjë nga këto ligje nuk ka parashikime të veçanta për ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve.

Forcimi i rendit dhe i sigurisë publike përbën një detyrim madhor të përhershëm. Puna për përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes dhe të treguesve në fushën e rendit publik krijon kushtet për jetën normale të qytetarëve, rrit nivelin e sigurisë publike, forcon lidhjet me qytetarët dhe kontribuon ndjeshëm në krijimin e një mjedisi të vështirë për të gjitha llojet e veprimtarive kriminale. Tabela më poshtë pasqyron treguesit e punës për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, si dhe të dhëna deri për 9-mujorin e vitit 2020.

Tabela 1: Treguesit e punës së NSPK-ve

Nr.	Indikatorët e punës së NSPK-ve	Viti 2019	Viti 2018	Krahasimi 2019 – 2018	Viti 2020 9 mujori
1	Kapur autorë të veprave penale, në flagrancë	2576	2941	-365	2241
2	Kapur autorë të veprave penale, në kërkim	745	689	+56	436
3	Informacione SK2, të regjistruara	16938	15390	+1548	12269
4	Raporte të ngjarjes	8259	7703	+556	6265
5	Persona të shoqëruar në polici	17267	17382	-115	13078
6	Kontrolle të ushtruara	172477	148809	+23668	232868
7	Armë pa leje të kapura/bllokuara	146	316	-170	109
8	Mbështetje të institucioneve të tjera	20683	16647	+4036	9288
9	Konflikte të evidentuara/trajtura	30835	35567	-4732	21888
10	Takime të zhvilluara	155175	141596	+13579	123817

Analiza e veprave penale të kryera gjatë vitit 2020

Veprat penale të kryera në lidhje me armëmbajtjen pa leje, ndërtime të paligjshme, dhunën në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe vepra penale në lidhje me rendin dhe sigurinë publike:

- evidentuar gjithsej **7628** vepra të tjera penale, nga të cilat janë zbuluar **7324**, ose **96%** tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 janë evidentuar **186** më pak ose **6.40%** vepra penale më pak;
- evidentuar **3240** vepra penale për armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit janë zbuluar **3138** ose **96.85%** e tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 ku janë evidentuar **3426** vepra penale për armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit, janë evidentuar **186** vepra më pak ose **5.4%** vepra penale më pak.

Vepra penale ndaj dhunës në familje

- Evidentuar gjithsej **1289** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **1289**, ose **100%** tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 janë evidentuar **143** më shumë ose **12.48%** vepra penale më shumë.

Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor

- Evidentuar gjithsej **4433** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **4219**, ose **95.2%** e tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezultojnë **283** vepra penale më pak ose **6.0%** vepra penale më pak.

Rendi dhe siguria publike

- Telefonata nga publiku gjithsej **541276** ose **104%** më shumë se e njëjta periudhë krahasuar me vitin e kaluar. Indikatorin për vitin: **7%** realizuar në masën **97%** ose **13.4 herë më shumë**;
- Në portalin “Komisariati Digjital”, janë evidentuar **38852** njoftime nga publiku ose **3.9%** më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.¹ Indikatorin për vitin: **7%** realizuar në masën **60%**;
- Aksidente rrugore me pasoja të rënda **153** raste, ose **29** raste më pak ose **15.4%** më pak;

¹ Albania 2020 Report Communication on EU Enlargement Policy.

- Për menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme për sigurimin e rendit publik, janë kryer 6227 aktivitete/shërbime/mbështetje, ose rreth 29.5% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Parandalimi dhe zhvillimi alternativ

Në qasjen parandaluese të kriminalitetit (qasje e cila mbizotëron në të gjitha policitë demokratike të botës perëndimore), koncepti i aksesit në siguri, nga të gjithë aktorët është jo vetëm i domosdoshëm por edhe i nevojshëm, duke marrë parasysh ndërlikimin e sfidave dhe ndarjen e përgjegjësi nga aktorë të ndryshëm. Në këtë kuadër, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucione të tjera, do të jetë në pararojë dhe do të luajë një rol të rëndësishëm në iniciimin dhe ndërtimin e një sistemi funksional dhe efektiv, parandalimi e ndërgjegjësimi, me të gjitha kategoritë vulnerabel, si viktimat e dhunës në familje, në shkollë, të miturit, përdoruesit e drogës, apo edhe kategori të tjera, viktimat dhe persona të varur nga fenomene kriminale. Krijimi i sistemit të referimit për kriminalitetin dhe prirjet ekstremiste sidomos për moshat e reja dhe puna e vazhdueshme me këto kontigjente, vlerësohet si mekanizmi i duhur parandalues.

Reformimi i Policisë Bashkiake

- Strukturat e Policisë Bashkiake, si një organ ekzekutiv në nivel lokal dhe me rol të rëndësishëm në garantimin e rendit dhe të qetësisë publike, duhet të rishikojnë mënyrën e organizimit të tyre, funksionimin dhe nivelin e ndërveprimit me struktura të tjera qendrore të sigurisë, si ato të Policisë së Shtetit, si dhe të përmirësojnë cilësinë e personelit të rekrutuar dhe menaxhimin e tij. Ndër masat kryesore në këtë drejtim është rishikimi i ligjit “Për Policinë Bashkiake”, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura. Po kështu, do të punohet për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe bashkëpunimin e ndërvlerësues me strukturat e Policisë së Shtetit.

Efektiviteti i qarkullimit rrugor dhe ulja e aksidenteve

- Ndryshimet e dëshiruara synojnë krijimin e një edukate dhe sjelljeje korrekte të qytetarëve në drejtimin dhe përdorimin e automjeteve, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për sjelljen në rrugë. Angazhimi i strukturave përgjegjëse të transportit rrugor dhe ato të rrugëve në monitorimin dhe menaxhimin e trafikut, duhet të jetë pjesë e punës koordinuese të strukturave të policisë në interes të rritjes së sigurisë rrugore. Përveç punës për ndërtimin e rrugëve, këto struktura duhet të ndjekin problematikën që paraqet cilësia dhe siguria e tyre, ngarkesa e trafikut dhe aspekte të lirshmërisë së qarkullimit. Për këtë qëllim, duhet që sa më parë të krijohet Qendra Operacionale e Qarkullimit Rrugor, e cila të mbledhë dhe të përpunojë të gjithë informacionin për qarkullimin rrugor në vend dhe të bëjë optimizimin e tij në mënyrë të përhershme.

Kjo qendër do të konceptohet dhe ndërtohet si një përpjekje e përbashkët e strukturave të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të lartpërmendura, do të miratohet dhe do të fillojë zbatimi i “Planit të Veprimit Policia Rrugore 2030”, i cili do të parashikojë masa të gjithanshme për përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator, përmirësimet organike, rritjen e profesionalizmit në radhët e Policisë Rrugore, komunikimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, mbështetjen teknologjike në shërbim të sigurisë rrugore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Pritshmëritë në këtë drejtim do të jenë menaxhimi bashkëkohor i trafikut rrugor dhe garantimi maksimal i sigurisë rrugore krahasuar me standardet evropiane.

Kontrolli dhe administrimi i territorit

- Kontrolli i plotë i territorit, në funksionon të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera me përgjegjësi në këtë drejtim. Rezultatet e arritura dhe përvoja e fituar në menaxhimin e vijës bregdetare dhe të hapësirave të plazhit tregojnë për mundësitë dhe hapësirat e shumta që ekzistojnë për një administrim më të mirë të territorit.

- Bashkëpunimi ndërmjet strukturave dhe institucioneve të ndryshme, por edhe ndarja e qartë e përgjegjësi ndërmjet Policisë së Shtetit, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), prefektëve dhe organeve të qeverisjes vendore do të luajë rol të rëndësishëm në përmbushjen e kësaj përgjegjësie. Në këtë kuadër, me prioritet do të vlerësohet mënyra e

organizimit dhe e integritit të tyre në një strukturë funksionale dhe efikase, si dhe ndërtimi i një bashkëpunimi të frytshëm me Policinë e Shtetit. Hartimi dhe zbatimi i një kuadri të plotë nënligjor e procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit do të jetë i një rëndësie të veçantë.

- Inspektoratet të organizojnë kontrollin e të gjithë territorit të vendit për ndërtime të paligjshme, por me fokus të veçantë në objekte me rëndësi kombëtare, të standardizojnë punën, bashkëpunimin dhe veprimtarinë e inspektorateve të mbrojtjes së territorit në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe të vlerësojnë performancën e tyre në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Reforma territoriale

- Objektivi i përgjithshëm i reformës dhe i ndryshimeve ligjore është krijimi i një sistemi efikas për dhënien e shërbimeve sa më efektive e cilësore për qytetarët dhe për mirëqenien e komuniteteve, nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të bashkive. Ligji i ri u mundëson bashkive të përmbushin funksionet e mëposhtme:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike;
- Shërbimet sociale;
- Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat publike, natyra dhe biodiversiteti;
- Zhvillimi ekonomik vendor;
- Siguria publike.

Rendi dhe Siguria në nivel vendor

- Në hierarkinë e nevojave bazike që kanë qytetarët, ato për rendin dhe sigurinë publike vijnë menjëherë pas atyre fiziologjike (strehim, ushqim, ujë, veshmbathje). Rëndësia e këtyre nevojave kërkon rrjedhimisht vëmendjen e bashkive për t'u mundësuar qytetarëve siguri, si në përditshmëri, ashtu dhe në situata të jashtëzakonshme. Në qytetet ku mbizotëron rendi dhe qetësia publike edhe mundësitë e zhvillimit, modernizimit dhe përthithjes së investimeve janë shumë më të mëdha. Njësitë e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin, përballimin dhe rimëkëmbjen nga situatat që krijohen nga fatkeqësi natyrore apo emergjencia civile të shkaktuara nga faktorë natyrorë, apo nga vetë njerëzit. Në përmbushjen e këtij roli bëjnë pjesë: krijimi i fondeve të mjaftueshme financiare për përballimin e situatave të tilla dhe për të ndihmuar banorët e dëmtuar, ngritja dhe funksionimi i strukturave për menaxhimin e këtyre situatave, mobilizimi i publikut dhe vullnetarëve për trajtimin dhe eliminimin e pasojave, si dhe funksionimi i sistemeve paralajmëruese në komunitet me qëllim shmangien apo minimizimin e rreziqeve.

- Bashkitë kanë kompetenca ligjore, që me anë të akteve të nxjerra, të parashikojnë veprimet që përbëjnë kundërvajtje administrative, si dhe të marrin masa parandaluese, detyruese e ndëshkuese për kundërvajtësit. Kuadri ligjor ekzistues u mundëson bashkive ngritjen dhe organizimin e shërbimeve të rendit dhe sigurisë publike, gjë që bën të mundur marrjen e masave administrative ndaj kundërvajtësve dhe parandalimin e veprimeve të tyre.

Sfidat

Problemet të cilat ndikojnë në sigurinë në komunitet, që nga aktet kriminale në fushën e sigurisë në komunitet e deri te problemet e funksionimit të mekanizmave relevantë në këtë fushë, janë një ndër sfidat kryesore për shtetin dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

Siguria dhe ruajtja e rendit publik mund të përmirësohen nëpërmjet ndërmarrjes së masave të mëposhtme:

- parandalimit të veprave penale dhe krimeve të tjera, duke u udhëhequr nga filozofia e “Policimit në komunitet”, përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me komunitetin dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

- sigurimit të ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie të re me biznesin, komunitetin në tërësi dhe shoqërinë civile në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve;

- përmirësimit të menaxhimit të qarkullimit rrugor, me synim minimizimin e aksidenteve; parandalimit dhe përbalimit të situatave emergjente;

- marrjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse dhe koordinimit më të mirë të mekanizmave në nivel qendror dhe vendor si p.sh: krijimi, forcimi dhe institucionalizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, ridimensionimi i rolit të prefektit për menaxhimin dhe koordinimin e kontrollit në territor dhe forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile në nivel kombëtar dhe vendor.

Në vitet e fundit, përmes një qasje më metodike ndaj policisë, policia po kërkon gjithnjë e më shumë një shpërndarje sa më racionale të përgjegjësisë bazuar në një ekzaminim të hollësishëm të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së policisë. Me nisjen dhe implementimin e procesit të decentralizimit, si dhe konceptit të policimit në komunitet, siguria publike tashmë ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, e cila tashmë do të synojë një përfshirje të institucioneve qendrore dhe vendore, të cilat kanë detyrime për çështjet e rendit publik.

Me gjithë parashikimet ligjore, bashkëpunimi ndërmjet strukturave vendore të policisë, pushtetit vendor dhe degëve vendore të institucioneve publike, nuk ka qenë në nivelin e pritshmërive. Po ashtu me gjithë angazhimin e PSH-së, ka pasur një përgjigje të vakët të institucioneve të tjera për të thelluar bashkëpunimin. Strategjitë vendore të sigurisë në komunitet rrallë janë konsultuar me partnerët lokalë dhe edhe më rrallë partnerët lokalë kanë ndërmarrë hapa konkrete për rritjen e sigurisë publike, duke koordinuar veprimet me PSH-n.

Këshillat Vendorë për Sigurinë Publike, megjithëse janë krijuar formalisht në disa bashki, nuk kanë pasur asnjë efekt praktik dhe gjenden ende larg pritshmërisë për të funksionuar si forume të diskutimit për çështjet e sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion. Po ashtu, nuk është realizuar përfshirja e komunitetit në kryerjen e shërbimeve policore të kontrollit të territorit, nëpërmjet aplikimit të praktikës së vullnetarizmit për problemet e sigurisë në komunitet.

Çështjet që lidhen me përgjegjësinë e ndarjes së informacionit dhe koordinimit me institucionet e tjera do të adresohen nëpërmjet forcimit të ligjit dhe përmirësimit të kapaciteteve institucionale, si dhe llogaridhënies.

Siguria është një e mirë publike aq e rëndësishme dhe e ndërlikuar, sa që ajo nuk mund të krijohet vetëm me kapacitetet e kufizuara të Policisë së Shtetit, kështu bashkëpunimi me qytetarët është parakusht i padiskutueshëm.

Legjislacioni i PSH-së do të vazhdojë të pasurohet për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të sigurisë dhe për t'u përafruar me atë të BE-së, duke konsideruar aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e Policisë.

Sfidë mbetet parandalimi i aksidenteve rrugore si një emergjencë kombëtare që përqendrohet te zbatimi i masave specifike me objektiv grupet, aktivitetet, sjelljet apo zonat me rrezikshmëri të lartë për aksidente, duke përsosur planifikimin dhe organizimin e shërbimeve në funksion të sigurisë në rrugë, efektshmërinë në shërbime, bashkëpunimin me aktorë të tjerë shtetërorë që kanë përgjegjësi kryesore dhe shoqërisë civile, si dhe rritja e fuqisë shtrënguese të ligjit ndaj shkelësve. Një punë specifike është bërë në kuadër të rritjes së parametrave të sigurisë rrugore, duke zbatuar masa konkrete për parandalimin e aksidenteve.

Gjatë viteve 2016 – 2018 policia rrugore u riorganizua, ku është implementuar sistemi i tabletave digjitale (250 njësi). Impakti i futjes së tyre në përdorim, përveç lehtësimit të punës në plotësim dhe verifikim në kohë reale të mjeteve, drejtuesve të mjeteve, alerteve të ndryshme ka qenë dhe identifikimi dhe kapja e shumë personave në kërkim në Tiranë, Durrës, Lezhë, Elbasan, Vlorë dhe në disa raste edhe të mjeteve të vjedhura, etj. Drejtoria e Policisë Rrugore ka draftuar projektin “*Detyra e projektimit për sistemin SENSOR*”, një projekt i integruar për monitorimin e akteve rrugore me kamera, radarë dhe me ANPR dhe targa RFID, projekt i cili është në pritje të financimit.

Në shkallë vendi, për vitin 2020, nga 346 zyra policore të planifikuara për t'u hapur pranë njësive administrative, janë hapur 236 zyra, nga të cilat 180 janë funksionale dhe mbeten për t'u hapur 110 zyra. Këto zyra janë të pajisura me pajisjet bazë për punë, por sfidë ngelen pajisjet teknologjike të përparuara si: kompjuter, printer, etj.

Me qëllim arritjen e një standardi të policimit, si dhe krijimit të një baze të shëndoshë zhvillimi për të ardhmen është i nevojshëm vijimi i reformimit të Policisë së Shtetit, që mund të realizohet nëpërmjet:

- infrastrukturës ligjore e organizative dhe përafrimit me standardet e BE-së;
- standardeve profesionale dhe qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore të policisë;
- kushteve të punës dhe teknologjisë së shërbimit policor.

4. Vizioni dhe misioni i strategjisë

Vizioni

Për të mundësuar një komunitet sa më të sigurt, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve institucionalë në nivel qendror dhe vendor, publik dhe privat, bazuar në partneritet, profesionalizëm, komunikim, transparencë dhe respekt të vlerave thelbësore.

Vizioni i dokumenti lidhet edhe me “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 – 2020”, kapitullin “Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës”, e lidhur më konkretisht me këta tregues, si më poshtë:

- ulja e sjelljeve antisociale dhe krimit të rrugës deri në 2020, kryesisht e veprave penale kundër pronës;
- përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut;
- përmirësimi i parametrave të sigurisë në rrugë deri në 2020, në përputhje me Visionin Zero të BE-së;
- rritja e standardeve të menaxhimit të burimeve njerëzore, e trajnimit, mjeteve të policisë, shërbimeve logjistike dhe monitorimit të buxhetit.

Misioni

Krijimi i një mjedisi sa më të sigurt për komunitetin, për të mbrojtur jetën dhe pronën, duke ofruar shërbime, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë, agjencitë e sigurisë publike, komunitetin, si dhe subjekteve të tjera publike dhe private. Kjo strategji synon të mbrojë dhe t'i shërbejë kërkesave të qytetarëve për një jetesë më të qetë, të sigurt dhe me vlera demokratike për të gjithë komunitetin.

Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë sigurimin e rendit publik, duke i shërbyer interesit publik me paanësi dhe duke mundësuar krijimin e një komuniteti, ku të gjithë ndihen të sigurt në mjedisin ku jetojnë.

Kjo strategji ndërsektoriale ka si mision krijimin e një mjedisi sa më të sigurt për komunitetin, për të mbrojtur jetën dhe pronën, duke ofruar shërbime, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë, agjencitë e sigurisë publike, komunitetin, si dhe subjekteve të tjera publike dhe private. Strategjia synon të mbrojë dhe t'i shërbejë kërkesave të qytetarëve për një jetesë sa më të qetë, të sigurt dhe me vlera demokratike për të gjithë komunitetin.

Në funksion të këtij misioni janë hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë sigurimin e rendit publik, duke i shërbyer interesit publik me paanësi dhe duke mundësuar krijimin e një komuniteti, ku të gjithë ndihen të sigurt në mjedisin ku jetojnë.

Strategjia ka bazën e saj në këto parime kyçe të sigurisë në komunitet:

Parimet bazë të sigurisë në komunitet

- **Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit** nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë në sigurinë në komunitet duhet të jenë përgjegjës dhe të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e kësaj strategjie;

- **Parimi siguria dhe mirëqenia për të gjithë:** një qasje gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë për të siguruar masa të rëndësishme dhe të përqendruara në grupet më vulnerabil;

- **Mjedise të sigurta:** të gjithë njerëzit kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të sigurt nga kërcënimet për sigurinë vetjake dhe mirëqenien e tyre personale.

- **Policia e Shtetit:** zhvillon veprimtarinë e udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionalitetit, pavarësisë operationale, integritetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies.

- **Parandalimi:** identifikimi i individëve ose i komuniteteve në rrezik dhe ndërhyrjet për të zvogëluar faktorët e rrezikut dhe/ose për të rritur faktorët e mbrojtjes.

- **Përdorimi i të drejtës së informimit dhe pjesëmarrjes publike:** kërkon përdorimin sa më të mirë të të gjitha të dhënave, informacionet dhe njohuritë e disponueshme, si dhe përdorimin e analizave, vlerësimit dhe shpërndarjes së informacionit për të siguruar që “Informacioni i duhur: të ndahet në mënyrë të përshtatshme për të ndërtuar “Pjesëmarrje publike” në iniciativat e sigurisë në komunitet”.

- **Pronësia e përbashkët:** nëpërmjet bashkëpunimit efektiv dhe përmirësimit të funksionalitetit në nivel vendor, përdorimit të informacionit, njohurive dhe burimeve për të trajtuar problemet në arritjen e rezultateve të përbashkëta që plotësojnë nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve.

- **Llogaridhënia:** nëpërmjet përmirësimeve në proceset e komunikimit dhe angazhimit, demonstron transparencën dhe llogaridhënia për aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra dhe përgjegjësinë ndaj komuniteteve dhe qytetarëve të Shqipërisë.

Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në analizat dhe vlerësimet e gjendjes aktuale dhe nevojat për adresimin e problemeve përkatëse në këtë fushë, si dhe në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe institucioneve e aktorëve pjesëmarrës në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik.

Pjesa e I e këtij dokumenti paraqet kuadrin metodologjik të hartimit të strategjisë së sigurisë në komunitet, mbështetur në analizën e situatës aktuale, ekspertët kanë përcaktuar vizionin, politikat dhe objektivat strategjike të sigurisë në komunitet për 6 vitet e ardhshme. Kreu I prezanton kuadrin aktual ligjor dhe institucional ku bazohet kjo strategji, si dhe analizën e situatës së përgjithshme të deritanishme të sigurisë, me qëllim identifikimin e fushave prioritare të ndërhyrjes.

Pjesa II paraqet në mënyrë të detajuar qëllimet e politikave dhe objektivat specifike të strategjisë, si më poshtë:

- Politika 1 rritja e parametrave të sigurisë në komunitet ka në fokus: 1.1 rritjen e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin; 1.2 evidentimin, parandalimin dhe trajtimin në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet; si dhe 1.3 rritjen e efikasitetit të kontrollit të territorit.

- Politika 2 angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin synon: 2.1 përmirësimin e komunikimit me publikun në lidhje me çështje të sigurisë në komunitet; 2.2. forcimin e bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë në Komunitet (KVSP-ve).

- Politika 3 fokusohet në reformimin e shërbimit policor dhe rritjen e kapaciteteve për sigurinë në komunitet nëpërmjet: 3.1. përmirësimit të strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimit të një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet; si dhe 3.2. përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë.

Pjesa e III përshkruan, nga pikëpamja organizative, planin e zbatimit të strategjisë, mënyrën e koordinimit dhe përgjegjësitë e institucioneve që marrin pjesë gjatë hartimit, zbatimit, raportimit dhe monitorimit të realizimit të treguesve të këtij dokumenti. Treguesit e monitorimit të rezultateve janë paraqitur në tabelën përkatëse (aneksi 1), si dhe në pasaportat e indikatorëve (aneksi 2) si element i rëndësishëm i procesit të monitorimit.

Pjesa e IV, “Burimet financiare”, paraqet parashikimet e kostove dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë, si dhe hendekun financiar. Kjo dokument strategjik shoqërohet nga “Plani i Veprimit 2021 – 2023”, i cili është hartuar nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Brendshme me kontributin e institucioneve përgjegjëse dhe miratohet me vendim të Këshillit të

Ministrave. Financimi i Planit të Veprimit do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve.

5. METODOLOGJIA

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, objektivat strategjike dhe specifike të parashikuar të përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike.

Nisma për hartimin e kësaj strategjie është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë, të rregulluar me vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”*.

Ministria e Brendshme, institucione të tjera si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, etj, si dhe Programi Suedezi për Policimin në Komunitet kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti, krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioritetëve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra në Studimin/anketën mbi Forcimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri (tetor – nëntor 2020), i mbështetur nga programi SCPA, me qëllim matjen e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve për punën e policisë së shtetit, impaktin e aktivitetit të policisë mbi jetën e përditshme të qytetarëve, si dhe krahasimin me valët pararendëse të studimit (2013, 2014 dhe 2018). Gjithashtu, ky dokument merr në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e bëra në rezultatet e sondazhit mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Shqipëri 2019 (OSBE),² si dhe ato të bëra në progresraportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020³.

Gjithashtu, ky dokument është publikuar për konsultim publik në fillim të dhjetorit 2020 në adresën: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/314_dhe_nuk_ka_pasur_komente_apo_sugjerime_të_tjera_në_lidhje_me_përmbajtjen.

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

Politika 1: Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet

Qëllimi i kësaj politike lidhet me parandalimin e kriminalitetit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit policor në kontrollin e territorit. Në këtë kuadër, siguria ka të bëjë me punën me njerëzit dhe komunitetet për të parandaluar krimin dhe sjelljet antishoqërore, për të zvogëluar dëmin dhe për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e jetës. Për ta arritur këtë, institucionet shtetërore do të fokusohen në masat parandaluese për të siguruar rritje efikase të parametrave të sigurisë nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërisë për sigurinë e komunitetit. Masat parandaluese do të lidhet me intensifikimin e përpjekjeve të të gjithë institucioneve, për të zbatuar konceptin e aksesit në siguri për të gjithë komunitetin dhe në zbatim të direktivave strategjike të vendit drejt integrimit në BE.

Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme do të udhëheqë perfeksionimin e sistemit aktual të parandalimit në praktikë, në bashkëpunim me të gjitha kategoritë shoqërore në komunitet, përfshirë grupet vulnerabël si: viktimat e dhunës në familje, viktimat e mitura/të mitur dhe të rritura/të rritur të dhunës seksuale, viktimat e përndjekjes dhe të dhunës në internet, në shkollë, të miturit, përdoruesit e drogës, bulizmin, apo edhe kategori të tjera me sjellje antishoqërore.

² <https://www.osce.org/secretariat/445501>.

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë , në partneritet me institucione dhe organizata të tjera, do të fokusohen në këto objektiva specifike:

Objektivi specifik

1.1

Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin;

Objektivi specifik

1.2

Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;

Objektivi specifik

1.3

Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit.

Objektivi specifik 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin

Strukturat e Policisë së Shtetit në veprimtarinë e tyre, krahas evidentimit të treguesve të punës, kryejnë analiza specifike bazuar në treguesit e performancës/punës, duke vlerësuar dhe klasifikuar nivelet e riskut për zonat e territorit (urbane dhe rurale) për rritje të tendencave të veprave penale apo të paligjshmërisë në territor.

Gjithashtu, Policia e Shtetit e ndërton punën e saj, krahas të tjerave edhe nëpërmjet grumbullimit të informacioneve të ndryshme policore që kanë të bëjnë me persona apo grupe të dyshuara kriminale që ushtrojnë veprimtari kriminale apo të paligjshme në territor, informacione të cilat pasi vlerësohen, shërbejnë për të ndërtuar punën policore në mënyrë proaktive, për parandalimin e kësaj veprimtarie kriminale apo të paligjshme.

Një element shumë i rëndësishëm është vlerësimi i risqeve, pasi nëpërmjet këtij vlerësimi, Policia e Shtetit dhe jo vetëm mund të përcaktojnë “zonat e nxehta” apo “njollat e zeza” në territorin/zonën policore, vlerësimet këto të cilat orientojnë planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve policore në këto vende për parandalimin e ngjarjeve të ndryshme (kriminale, paligjshmëri, aksidente rrugore, etj.).

Treguesit kryesorë të performancës

1.1.1 Rezultatet e treguesve të punës së strukturave të policisë së shtetit, krahasuar me periudhat paraardhëse në lidhje me parametrat e sigurisë në komunitet.

Indikatorë të matshëm

1.1.1.1 Numri i informacioneve policore (SK2);

1.1.1.2 Numri i veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet (vrasjet, plagosjet, krimet seksuale, rrëmbimet, shtrëngim për dhënie pasurie, dhunim banese, përndjekja, dhuna në familje vjedhjet, mashtrimi, shkatërrimi i pronës, organizimi i lotarive të palejuara, ndërtimet e paligjshme, krimet kundër mjedisit, largim nga vendi i aksidentit, prishje e qetësisë publike, vetëgjyqësia, krime në fushën e narkotikëve, shkelje rregullave të qarkullimit rrugor).

Rezultate të pritshme

1.1.1.1 Rritja e numrit të informacioneve policore (SK2);

1.1.1.1 Rritja e forcës goditëse, numrit të personave të proceduar penalisht/arrestuarve/ndaluarve për veprimtari kriminale apo paligjshmëri në territor;

1.1.1.2 Ulja e numrit të veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet (vrasjet, plagosjet, krimet seksuale, rrëmbimet, shtrëngim për dhënie pasurie, dhunim banese, përndjekja, dhuna në familje, vjedhjet, mashtrimi, shkatërrimi i pronës, organizimi i lotarive të palejuara, ndërtimet e paligjshme, krimet kundër mjedisit, largim nga vendi i aksidentit, prishje e qetësisë publike, vetëgjyqësia, krime në fushën e narkotikëve, shkelje rregullave të qarkullimit rrugor).

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese

Kjo masë synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si në nivel qendror me ministrinë e linjës dhe në nivel vendor me agjencitë zbatuese nëpërmjet KVSP-ve, për vlerësimin e riskut dhe dëmit, si dhe marrjen e masave parandaluese në lidhje me çështje të rëndësishme për sigurinë si: dhuna, kriminaliteti në komunitet, shpërndarja dhe përdorimi i lëndëve narkotike në komunitet. Kjo do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të masave ligjore dhe mekanizmave në nivel vendor e qendror për adresimin e këtyre çështjeve nëpërmjet vlerësimit të riskut dhe përforcimit të masave aktuale nga të gjithë agjencitë ligjzbatuese, si dhe nëpërmjet koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve me mekanizmat ekzistues, si për shembull: Mekanizmat e Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës në familje, në nivel vendor, Grupin Teknik ndërsektorial për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, tryezat antitrafik, për trajtimin e rasteve në rrezik trafikimi, etj.

KSVP-të, nëpërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe forumeve e mekanizmave të tjerë të bashkëpunimit, do të punojë për të siguruar ndërhyrje specifike për sigurinë në nivel vendor, duke siguruar kështu një kundërnarrativë për të sfiduar dhe parandaluar krimet në komunitet.

Masa 2. Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike

Në lidhje me vlerësimin e riskut, masat do të fokusohen në kryerjen e vlerësimeve të riskut në komunitete mbi baza lokale, sipas modelit të analizave SMSK (*Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet*), i realizuar nga programi suedez “**Forcimi i sigurisë në komunitet në Shqipëri**” (SCPA), ose modele të tjera të përdorura nga Policia e Shtetit apo agjencitë e tjera në bashkëpunim me KSVP-të dhe partnerë të tjerë, po ashtu të dhënat do të krahasohen në nivel qarku dhe ato në nivel kombëtar.

Prioritet do t’i kushtohet modernizimit të sistemit, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të avancuara të teknologjisë së informacionit, për përpunimin e të dhënave, si dhe shfrytëzimin e databazave të të gjithë institucioneve përgjegjëse që kanë detyrime në këtë fushë.

Masa 3. Proaktiviteti i shërbimit policor në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve

Një rol të rëndësishëm për arritjen e këtij objekti do të vazhdojë të luajë dhe Policia e Shtetit, e cila do të përdorë analizën e performancës, për të kuptuar më mirë kërkesat operacionale me të cilat përballlet çdo ditë, për të siguruar që plotëson sfidat e çështjeve rutinë, si dhe kërcënimet dhe sfidat e reja në baza lokale, rajonale dhe kombëtare.

PSH-ja do të përqendrohet në modernizimin e teknologjisë dhe sistemeve të TIK-ut për të përmirësuar mbledhjen, analizën dhe përdorimin e informacionit të Policisë që synon parandalimin dhe zgjidhjet e orientuara drejt problemit.

PSH-ja do të rishikojë vazhdimisht Sistemin e Menaxhimit Policor të Çështjes për të siguruar që mbetet i përshtatshëm, për qëllimin dhe se gatishmëria e Policisë për të reaguar ndaj emergjencave civile, incidenteve të vazhdueshme ose të drejtpërdrejta dhe patrullimi i policisë bazohet në informacionin dhe proceset më të mira në dispozicion.

Në fokus do të jetë dhe forcimi i bashkëpunimit të strukturave policore brenda Zonave Policore dhe bërja funksionale 100% e këtyre zonave nëpërmjet plotësimit të strukturave dhe mbështetjes logjistike.

Objekti i specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet

Qëllimi i këtij objekti është që institucionet përgjegjëse dhe komuniteti të bashkëpunojnë ngushtësisht për të identifikuar problemet, për të vendosur përparësi dhe për të gjetur zgjidhje për problemet siç janë: krimi, abuzimi me drogat, frika nga krimi, çështjet sociale, sjelljet antishoqërore, problemet ekologjike dhe shqetësime të tjera në mjedisin jetësor dhe punës në komunitet.

Analiza e situatës dhe sfidat

Strukturat e Policisë së Shtetit kryejnë identifikimin e problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit nëpërmjet denoncimeve, ankesave të drejtpërdrejta në organet e policisë, kallëzimeve të qytetarëve, kontakteve të përditshme që kanë në zonën policore, takimeve të ndryshme me përfaqësues të pushtetit vendor, institucioneve vendore shtetërore, pjesëmarrjes në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar etj.

Megjithëse, ky evidentim aktualisht kryhet në këto forma, vlerësohet shumë i rëndësishëm aktivizimi në këtë proces i të gjithë aktorëve të tjerë si pushtetit vendor, institucione të tjera vendore shtetërore, subjekte të ndryshme private, organizata OJF, komunitetet fetare, etj., si pjesë integrale e jetës së komunitetit në një territor të caktuar, ku edhe këto problematika, shqetësime janë të pranishme çdo ditë.

Referuar kësaj situatë dhe problematikave nevojitet:

- krijimi i mekanizmave specifikë, si dhe fuqizimi i mekanizmave ekzistues për adresimin e problematikave dhe shqetësimeve të evidentuara, të cilat duhen ndarë sipas prioritetëve për t'u trajtuar;

- krijimi i strukturave të specializuara (si KVSP, etj.) dhe koordinimi i veprimeve të tyre me mekanizmat/strukturat ekzistuese, për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit;

- krijimi i buxheteve të veçanta për zgjidhjen e problematikave dhe shqetësimeve të tilla që kërkojnë mbështetje financiare.

Treguesit kryesorë të performancës

1.2.1 Parandalimi i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni nëpërmjet evidencave dhe raporteve të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë që kontribuojnë në fushën e sigurisë në komunitet;

1.2.2 Bashkëpunimi me sistemin arsimor me qëllim parandalimin.

Indikatorë të matshëm

1.2.1.1 Numri i rasteve të evidentuara dhe të sjella nga institucionet përgjegjëse, përfshirë policinë në KVSP;

1.2.1.2 Numri i masave parandaluese të marra nga institucionet përgjegjëse bazuar në evidencat dhe raporte;

1.2.1.3 Numri i anketimeve dhe analizave, në nivel vendor dhe kombëtar, mbi perceptimin e publikut në lidhje me rendin dhe sigurinë;

1.2.2.1 Shtrirja e rolit të oficerëve të sigurisë në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare, të vendit (aktualisht kjo strukturë funksionon vetëm në 150 gjimnaze);

1.2.2.2 Fuqizimi i rrjetit të institucioneve arsimore parauniversitare – qendra komunitare.

Rezultate të pritshme

1.2.1.1.1 Rritja e evidencave dhe informacioneve zyrtare të institucioneve përgjegjëse që përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitet dhe në territor;

1.2.1.1.2 Rritja e numrit të informacioneve cilësore policore;

1.2.1.1 & 1.2.1.3 Rritja e ndërveprimit për parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollat parauniversitare nëpërmjet mësuesit, drejtuesit të shkollës dhe Policisë (SPZ) dhe komuniteteve nëpërmjet mekanizmit: shkolla si qendër komunitare.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 4. Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit, i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni

Qëllimi është reduktimi i aktiviteteve të kontrollit nëpërmjet masave që parandalojnë krimin, zvogëlojnë frikën e krimit dhe përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitet dhe në territor. Parandalimi i orientuar nga inteligjenca (evidentimi dhe informacioni) do të sigurojë reduktimin e përsëritjes së çështjeve që cenojnë sigurinë në komunitet, analizën e pikave të nxeha, orientimin për plane specifike të parandalimit dhe të zvogëlimit të krimit, të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe një shërbim policor efikas.

Policimi që udhëhiqet nga informacioni është koncepti që sfidon modelin tradicional dhe reagues të policimit, ndërkohë që policimi në komunitet është një qasje vertikale, për të ndërtuar besimin e publikut te policia, policimi i udhëhequr nga intelijenca (informacioni) është një model drejtimi dhe vendimmarrje nga lart – poshtë. Modeli i policimit që udhëhiqet nga intelijenca fokusohet tek analiza dhe informacioni i përpunuar si elemente thelbësorë për vendimmarrjen objektive e që ka si prioritet zonat e rrezikuara të kriminalitetit, si dhe parandalimin e goditjes e aktiviteteve kriminale, nëpërmjet menaxhimit nga pikëpamja teknike e strategjike etj.

Ky policim i udhëhequr nga intelijenca do të ndihmonte në zgjidhjen e shumë problemeve, pasi policia merr masa proaktive parandaluese në kohë, bazuar në informacionet e marra dhe kjo do të reduktonte kryerjen e kontrolleve në territor, si patrullime etj.

Institucionet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë që kontribuojnë në fushën e sigurisë në komunitet, të bazuar në evidenca dhe informacion për çështje që shqetësojnë komunitetin, të koordinuar apo në bashkëveprim me KVSP-të, do të rishikojnë vazhdimisht rolin e tyre në përmirësimin e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe në ngritjen e fushatave ndërgjegjëse për çështjet e krimit lokal dhe rendit dhe sjelljeve antishoqërore përmes ndërveprimit efektiv me komunitetin, si në institucione arsimore parauniversitare, biznese, apo dhe me OJF/OSHC, për t'u fokusuar në komunitete më pak të arritshme dhe më pak të dukshme.

Të gjithë aktorët përgjegjës, nëpërmjet KVSP-ve, do të mbledhin, analizojnë, vlerësojnë dhe shpërndajnë informacione në mënyrë proaktive, bazuar në informacionin më të plotë të mundshëm, në mënyrë që të informojnë KVSP-të, mekanizmat e tjerë ekzistues (ETN-të, GNT-të, tryezat antitrafik etj.) dhe komunitetet për problemet, trendet dhe çështjet në zhvillim.

PSH-ja do të sigurojë mbështetje për politikat, analizat dhe taktikat për KVSP-të duke u përqendruar në mbrojtjen e grupeve më vulnerabël në komunitet, PSH-ja do të sigurojë që sistemet, proceset dhe procedurat që kjo strukturë përdor janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të të drejtave të njeriut dhe do të përpiqet të arrijë rezultatet më të mira, duke marrë në konsideratë dhe duke respektuar nevojat e veçanta të këtyre grupeve.

Fushatat e ndërgjegjësimit do të jenë të bazuara në evidenca dhe inteligjencë të lidhura me shqetësimet specifike të sigurisë në komunitet. Aktivitetet ndërgjegjëse do të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për çështje të ndryshme të sigurisë në komunitet dhe publikut, si rezultat i ndërveprimit gjatë këtyre veprimtarive dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet/problematikat e ngritura në lidhje me sigurinë.

Masa 5. Parandalimi nëpërmjet edukimit

Edukimi në sistemin arsimor synon edukimin nëpërmjet programeve shkollore me sjelljet që nxisin sigurinë vetjake dhe të të tjerëve në situata të ndryshme, si dhe ndryshimet ndërmjet sjelljeve të rrezikshme dhe të sigurta. Në fokus do të jetë dhe rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të sistemit arsimor në funksion të rritjes së parametrave të sigurisë publike.

Në fokus do të jetë zhvillimi i protokolleve gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe raportimin e dhunës, ngacmimit dhe sulmeve seksuale, bulizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucione arsimore parauniversitare. Përmes praktikave më të mira në rajon, në institucione arsimore parauniversitare do të krijohen ekupe të përbëra nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit që kanë për synim krijimin e mjediseve pa dhunë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve mes nxënësve. Gjithashtu, do të investohet në ndërtimin e kapacitetit të ekupeve të tilla dhe në koordinimin e tyre nga ZVAP-të. Një rol të rëndësishëm këtu do të kenë bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve me bashkinë/koordinatorin vendor dhe ETN-të për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, apo dhe NJMF-të/PMF-të dhe GTN-të për rastet e abuzimit të fëmijëve.

Shtrirja e rolit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare, në të gjitha institucionet arsimore të vendit (aktualisht kjo strukturë funksionon vetëm në 150 gjimnaze), përfshirë këtu shkollat fillore. Kjo strukturë është e domosdoshme për sinjalizimin, parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollë nëpërmjet ndërveprimit me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe Policisë (SPZ). Qëllimi i kësaj strukture nuk është ndëshkimi, por ndërgjegjësimi,

edukimi dhe ofrimi i mbështetjes mbi problematikat e sigurisë që nxënësit mund të hasin në ambientet e shkollës.

Fuqizimi i rrjetit të institucione arsimore parauniversitare do të realizohet edhe nëpërmjet shtimit të numrit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare. MASR-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në zbatim të vendimit nr. 600, datë 9.10.2018, *“Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”*, të ndryshuar, ka bërë të mundur punësimin e oficerëve të sigurisë në të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë, si dhe në institucione arsimore parauniversitare të arsimit bazë që plotësojnë kriteret e caktuara në kuptim të numrit të nxënësve, vendndodhjes, vlerësimit të sigurisë etj. Trajtimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet nga Akademia e Sigurisë.

Fuqizimi i rrjetit të institucioneve arsimore parauniversitare – qendrave komunitare do të vijojë, mbështetur në eksperiencat më të mira, përftuar gjatë zbatimit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014 – 2020, ndërsa fokusi në periudhën 2021 – 2026 do të jetë në fuqizimin e rrjetit të këtyre institucione arsimore parauniversitare në nivel të ZVAP-ve, DRAP-ve dhe në nivel vendi. Në këtë formë synohet që të shtohen mundësitë për shkëmbim të përvojave në mes të institucioneve arsimore parauniversitare – qendrave komunitare, duke i nxitur ato për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së tyre. Bashkëpunimi në këtë qasje do të fuqizohet edhe me mjekët e shkollave ku ekzistojnë, si dhe me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social.

Me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së materialeve edukuese do të mundësohet që paketat edukuese për çështje të ndryshme të jenë të përgatitura nga ekspertë të fushës nëpërmjet qasjes shumëdisiplinare, të përputhura me moshën dhe nevojat e tyre, si dhe të publikuara në një faqe të caktuar të portalit policor dhe arsimor.

Objektivi specifik 1.3: Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit

Kontrolli i plotë i territorit, në funksion të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e një sërë aktorëve që kanë detyrim ligjor në këtë drejtim. Ky kontroll përfshin një tërësi procesesh, duke filluar nga mbikëqyrja e zonave urbane dhe rurale, zonave turistike duke prekur të gjitha hapësirat e tjera (malore, fushore, pyjore, etj.) në të gjithë territorin e vendit për parandalimin e veprave penale dhe paligjshmërisë në territor. Përfundimi i reformës territoriale, së bashku me ndryshimet e fundit ligjore⁴, ngarkon bashkitë me përgjegjësi në raport me kontrollin e territorit dhe garantimin e sigurisë publike.

Masat që do të merren në këtë drejtim do të fokusohen kryesisht në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe institucioneve të ndryshme të përfshira në kontrollin e territorit dhe zbatimin e kuadrit ligjor përkatës. Në fokus do të jenë edhe puna për krijimin e “qyteteve të sigurta për gratë dhe vajzat” (në përputhje me OZHQ-të 11.7), të cilat mund të lëvizin pa frikën e ngacmimit apo dhunës (verbale, fizike e seksuale) në hapësirat publike urbane dhe rurale.

Analiza e situatës dhe sfidat

Kontrolli i territorit vlerësohet shumë i rëndësishëm sa i përket konstatimit të paligjshmërisë dhe veprimtarisë kriminale në territor. Në aktet ligjore dhe nënligjore janë të mirëpërcaktuara kompetencat dhe përgjegjësitë që kanë aktorë të ndryshëm për kontrollin e territorit, por aktualisht perceptohet si një përgjegjësi dhe punë kryesisht e Policisë së Shtetit.

Strukturat vendore të Policisë së Shtetit janë të organizuara dhe të ndara në të gjithë territorin dhe ushtrojnë përgjegjësitë e tyre funksionale dhe realizojnë detyra në kontrollin e territorit për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe të paligjshmërisë në territor, por aktorët e tjerë vendorë që kanë detyrime për kontrollin e territorit, nuk ushtrojnë përgjegjësitë që i ngarkon ligji ose i ushtrojnë ato në nivele minimale, për shumë arsye dhe faktorë objektiv e subjektiv.

Për një kontroll sa më të mirë dhe efektiv të territorit është e rëndësishme dhe e nevojshme marrja e përgjegjësi, si dhe forcimi i bashkëpunimit të të gjitha strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

⁴ Referencë ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Hartimi i një Procedure Standarde Pune/Veprimi (PSV) "Mbi mënyrat e bashkëpunimit dhe kryerjes së veprimeve/kontrolleve të përbashkëta të territorit për evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor", konsiderohet i nevojshëm, ku të përfshihen të gjithë aktorët qendrorë e vendorë që kanë detyrime ligjore në këtë fushë.

Treguesit kryesorë të performancës

1.3.1 Kontroll cilësor dhe efektiv i territorit nëpërmjet zbatimit të përgjegjësi të strukturave të ndryshme, institucioneve dhe organeve të vetëqeverisjes vendore dhe qendrore për të përmirësuar kontrollin e territorit.

1.3.2 Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit në mënyrë sa më efektive, me qëllim evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor.

Indikatorë të matshëm:

1.3.1.1 Hartimi i një kuadri të plotë nënligjor dhe procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të inspektorateve që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;

1.3.1.2 Riorganizimi i strukturave që kanë përgjegjësi, duke i shtuar kompetenca të reja për kontrollin e territorit dhe inspektimin, përfshirë pushtetin vendor;

1.3.1.3 Krijimi dhe aktivizimi i grupeve vullnetare pranë njësive administrative për kontroll territori;

1.3.2.1 Mundësimi dhe përdorimi i mjeteve logjistike me teknologji inovative, për kryerjen e kontrolleve efektive dhe pajisja me automjete e strukturave vendore përgjegjëse, për kontrollin e territorit.

Rezultate të pritshme

1.3.1.1 Akte të hartuara që rregullojnë kuadrin nënligjor për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të inspektorateve që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;

1.3.1.2 Formulimi i akteve që rregullojnë kuadrin nënligjor për veprimtarinë e pushtetit vendor me përgjegjësi për kontrollin e territorit;

1.3.1.3 Rritja e numrit të njësive administrative që kanë grupet vullnetare të aktivizuara për kontrollin e territorit;

1.3.1.1.1 Rritja e numrit të automjeteve në dispozicion të strukturave përgjegjëse (inspektoratet) në nivel vendor për kontrollin cilësor të territorit;

1.3.1.1.2 Rritja e numrit të zonave policore të mbuluara me pajisje teknologjike (dronë, dylbi, GPS, tableta dhe pajisje të tjera.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 6. Zbatimi i përgjegjësi në nivel qendror dhe vendor për kontrollin e territorit

Ministria e Brendshme dhe institucionet shtetërore në nivel kombëtar do të identifikojnë ndarjen më të qartë të përgjegjësi ndërmjet strukturave të ndryshme, institucioneve dhe organeve të vetëqeverisjes vendore dhe qendrore për të përmirësuar kontrollin e territorit.

Në fokus do të jenë:

- ndërtimi i protokolleve dhe përmirësimi i legjislacionit për shkëmbimin e informacionit për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kryesore që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;

- riorganizimi i strukturave që kanë përgjegjësi duke i shtuar kompetenca të reja për kontrollin e territorit dhe inspektimin;

- hartimi i një kuadri të plotë nënligjor dhe procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të këtyre inspektorateve.

Masa 7. Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit

Kjo masë synon pajisjen e strukturave vendore që kanë detyrime për kontrollin e territorit me automjete të kalueshmërisë së lartë dhe pajisje të tjera si: dronë, dylbi, veshje etj., për kryerjen e kontrolleve sa më efektive, me qëllim evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor. Po ashtu do të ndërmerren hapa të mëtejshme, në zbatim të detyrime të përcaktuara në ligjin nr. 19, datë 22.9.2016, "Për masat shitesë të

sigurisë”, si vendosja e kamerave nga subjektet e ndryshme private në ambientet e jashtme, si dhe ngritja dhe funksionimi i një regjistri, si bazë të dhënash në nivel qendror apo vendor, në të cilin regjistrohen subjektet që sipas ligjit, marrin masa shtesë të sigurisë publike, etj.

Politika 2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin

Kjo politikë është në thelb të filozofisë së zbatimit të kësaj strategjie, duke synuar vendosjen dhe ruajtjen e besimit të ndërsjellë si qëllim kryesor të komponentit të parë thelbësor të sigurisë në komunitet, atë të partneritetit të komunitetit. Politika synon rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, ku siguria bëhet pjesë integrale e kulturës së komunitetit dhe ndërveprimi midis komunitetit dhe organeve të pushtetit vendor ndihmon në besimin e ndërsjellë, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve dhe shpërndarjen e burimeve.

Suksesi afatgjatë i sigurisë në komunitet nuk varet vetëm nga transformimi i policisë nëpërmjet zbatimit të ligjit, por edhe nga transformimi dhe gatishmëria e pushteti vendor për të ndjekur një integrim efektiv të zbatimit të filozofisë në nivel vendor. Përfaqësuesit e zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor duhet të kuptojnë zbatimin e strategjisë së sigurisë në komunitet si pjesë e zbatimit të ligjit dhe të marrin pjesë aktive në zhvillimin e saj. Kryetarët e bashkive, njësite administrative nuk duhet të jenë partnerë pasivë në këtë proces, ata duhet të udhëzojnë zgjerimin e kësaj lëvizje drejt “qeverisë së orientuar nga komuniteti” në nivelin vendor. Koordinimi dhe bashkëpunimi me organizatat, forumet dhe institucionet joqeveritare konsiderohet si shumë i rëndësishëm, pasi përfshirja e tyre do të kontribuojë në sigurinë e komunitetit.

Gjithashtu, bashkëpunimi dhe angazhimi proaktiv i policisë së shtetit në mekanizmat ekzistues të trajtimit të problemeve të ndryshme shoqërore, si MKR-ja kundër dhunës në familje, GTN-ja kundër abuzimit të fëmijëve, tryezat antitrafikim etj. Përfshirja aktive e komunitetit çon në zgjidhje proaktive dhe të orientuara e të drejtuara, forcon besimin tek institucionet shtetërore dhe gjithashtu çon në përmirësimin e komunikimit, performancës dhe kënaqësisë më të mirë ndaj shërbimeve shtetërore për të përmbushur nevojat e komuniteteve.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë do të fokusohen në përmbushjen e objektivave specifike të mëposhtëm:

Objektivi specifik 2.1

Përmirësimi i komunikimit me publikun.

Objektivi specifik 2.1

Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve.

Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun

Komunikimi është një nga vlerat kryesore të sigurisë në komunitet, i cili duhet të jetë në kohë, gjithëpërfshirës dhe i drejtpërdrejtë. Komunikimi në mënyrë të vazhdueshme me publikun do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive dhe uljen e rezistencës për bashkëpunim dhe ndërveprim dhe rritjen e besimit të publikut për përmirësimin e sigurisë.

Analiza e situatës dhe sfidat

Raportet e komunikimit të policisë me publikun mbeten në themel të përpjekjeve të forcimit të bashkëpunimit të policisë me komunitetin, duke forcuar besimin e publikut te policia dhe duke ndërvepruar përpjekjet për parandalimin e krimit dhe ofrimin e sigurisë. Ky raport ndërmjet tyre është i një rëndësie të veçantë, duke u lidhur drejtpërsëdrejti me përmirësimin e shërbimeve të sigurisë ndaj qytetarëve në bashkëpunim të ngushtë me ta. Bashkëpunimi i strukturave të policisë në nivel qendror dhe vendor me komunitetin, në interes të drejtpërdrejtë të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve nevojitet të fuqizohet, si dhe të jetë i drejtpërdrejtë e nga afër, në mënyrë që ndërveprimi të jetë më eficient. Po ashtu një rëndësi të veçantë merr përdorimi i mundësive më të

mira teknologjike për të lehtësuar komunikimin, të cilat ofrojnë zgjedhje dhe më shumë facilitete për njerëzit që zgjedhin të kontaktojnë, me opsione të zgjeruara digjitale dhe akses të përmirësuar.

Në kuadër të marrjes së përgjegjësisë të të gjitha strukturave përgjegjëse për çështjet e sigurisë në komunitet, si dhe me ngritjen e KSVP-ve, zhvillimi i “Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale” është me rëndësi për nxitjen e besimit të publikut, duke theksuar arritjet e sigurisë lokale dhe sigurisë në komunitet duke demonstruar përgjegjshmëri dhe rezultate, si dhe duke punuar në partneritet, dhe duke koordinuar me planet e tjera të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit që hartohen nga struktura ku edhe vetë PSH-ja është anëtare (MKR etj.);

Treguesit kryesorë të performancës

2.1.1 Zhvillimi i “Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale”;

2.1.2 Përmirësimi i komunikimit të NSPK-ve me qytetarët dhe bashkërendimi i punës së NSPK-ve me strukturat e tjera vendore, si dhe forcimi i rolit të oficerëve të sigurisë në shkolla;

2.1.3 Përmirësimi i komunikimit nëpërmjet kanaleve të ndryshme mediatike të komunikimit;

2.1.4 Rritja e transparencës në punën institucionale të DPPSH-së dhe bashkive në lidhje me çështje të sigurisë në komunitet, nën garancinë e Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Indikatorë të matshëm

2.1.1.1 Numri KVSP-ve me “Plane specifike të komunikimit të sigurisë lokale”;

2.1.1.2 Numri i KVSP-ve që komunikojnë raporte specifike të publiku mbi çështjet e adresuara nga KVSP-të;

2.1.2.1 Numri i takimeve nga NSPK me oficerët e sigurisë në shkolla, me qytetarët në lagje, fshatra i evidentuar dhe komunikuar me komunitetin;

2.1.3.1 Numri i kanaleve të reja mediatike të komunikimit ose rubrikave të përmirësuara;

2.1.4.1 Programi i transparencës i përditësuar çdo vit nga DPPSH-ja dhe bashkitë.

Rezultate të pritshme:

2.1.1.1.1 Rritja e numrit të KVSP-ve me “Plane specifike të komunikimit të sigurisë lokale”;

Rritja e numrit të raporteve të punës të KVSP-ve të komunikuar me publikun;

2.1.1.1.2 Rritja e numrit të takimeve nga NSPK me oficerët e sigurisë në shkolla, me qytetarët në lagje, fshatra;

2.1.1.1.3 Rritja e informacioneve të ndara nga grupet e ndryshme të komunitetit gjatë takimeve me NSPK-të;

2.1.3.1 Rritja e numrit të kanaleve të reja mediatike të komunikimit ose rubrikave të përmirësuara në lidhje me sigurinë në komunitet;

2.1.4.1.1 Rritja e numrit të publikimeve të raporteve vjetore të çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet (përfshirë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve);

2.1.4.1.2 Rritja e numrit të përdoruesve të programit “Komisariati digjital”.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmblotjes së masave të mëposhtme:

Masa 8. Hartimi dhe zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kontaktet e drejtpërdrejta me publikun dhe komunitetet

Masat do të fokusohen në përmirësimin e komunikimit të NSPK-ve me qytetarët dhe bashkërendimin e punës së NSPK-ve me strukturat e tjera vendore. **Forcimi i rolit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare** konsiderohet një element tjetër i rëndësishëm sa i takon përmirësimin e komunikimit me publikun. Gjithashtu, me rëndësi është dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet komunikimeve dhe këshillimeve për shërbimet e ofruara nga policia dhe hartimi e zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kanalet e komunikimit dhe mjetet e kontaktit me publikun, si dhe metodat e komunikimit për të nxitur besimin e publikut ndaj shërbimeve policore, duke i afruar qytetarët më pranë me Policinë e Shtetit përmes kësaj forme partneriteti dhe pjesëmarrjeje. Koordinimi i veprimeve dhe pjesëmarrje në aktivitetet specifike ndërgjegjësuëse, të cilat organizohen në kuadër të ditëve apo fushatave mbarëkombëtare (ose ndërkombëtare), lidhur me të drejtat e fëmijëve, fushatën antitrafikim, fushatën e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje, etj.

Masa 9. Përmirësimi i komunikimit dhe angazhimit efektiv me partnerët dhe komunitetet në nivel lokal dhe kombëtar

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- zhvillimit të “Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale” që nxisin besimin e publikut, duke theksuar arritjet e sigurisë lokale dhe sigurisë në komunitet duke demonstruar përgjegjshmëri dhe rezultate, si dhe duke punuar në partneritet, dhe duke koordinuar me planet e tjera të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit që hartohen nga struktura ku edhe vetë PSH-ja është anëtare (MKR etj);

- krijimit të një strategjie specifike komunikimi të jashtëm, duke përdorur praktikën më të mirë ndërkombëtare, të përshtatur me kushtet dhe kulturën shqiptare;

- demonstrimit dhe promovimit për rolin e parandalimit përmes nxjerrjes në pah të veprimtarisë ekzistuese të institucioneve përgjegjëse dhe nga KVSP-të, si dhe qasjet inovative të komunikimit për parandalimin e krimit dhe prishjen e rendit publik;

- marrjes së masave proaktive në krijimin e kontakteve dhe komunikimin me grupet e pakicave dhe të disavantazuara në komunitet për të luftuar pabarazinë, në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të që janë shpesh zëri i këtyre grupeve.

Masa 10. Hartimi dhe zbatimi i masave për të përmirësuar komunikimin nëpërmjet mediave teknologjike

Perceptimet e publikut ndaj çështjeve të rendit dhe sigurisë dhe policisë janë të një rëndësie të mashe, sepse në fund të fundit policia dhe organet e tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit nuk mund të jetë efektive pa mbështetjen e publikut. Mungesa e mbështetjes nga publiku do t'i bënte këto institucione dhe policinë të paaftë për të kapur shkelësit e rendit si dhe kriminelët. Në këtë kuadër komunikimi në kohë reale dhe i vazhdueshëm me publikun merr rëndësi të veçantë. Po ashtu rëndësi të veçantë merr dhe përdorimi sa më i gjerë i kanaleve të komunikimit nëpërmjet aksesit të teknologjive të reja të komunikimit.

Kjo masë synon të shqyrtohen mundësitë më të mira teknologjike për të lehtësuar komunikimin, të cilat ofrojnë zgjedhje dhe më shumë facilitete për njerëzit që zgjedhin të kontaktojnë, me opsione të zgjeruara digjitale dhe akses të përmirësuar. Kjo masë synon të realizohet nëpërmjet:

- përdorimit të kanaleve të reja të mediave sociale të komunikimit si *Facebook* dhe *Twitter* për të zhvilluar plane komunikimi dhe angazhimi që arrijnë të gjitha komunitetet, bizneset dhe palët e tjera të interesit në një mënyrë proaktive dhe inovative;

- përmirësimit të mbështetjes së mediave dhe mënyrës së shpërndarjes së mesazheve te mediat lokale;

- fuqizimit të mëtejshëm dhe rivendosjes në qendër të vëmendjes të Komisarariatit Digjital si një platformë unike për adresimin e ankesave.

Masa 11. Zbatimi i masave të komunikimit në kuadër të programit të transparencës për të përmirësuar sistemin e raportimit dhe informimit të publikut

Komunikimi i strukturave përgjegjëse për sigurinë me publikun, është një element kyç, i cili synon të përmirësojë imazhin e strukturave të Policisë së Shtetit nëpërmjet rritjes së shkallës së transparencës duke informuar publikun mbi aksione/operacione, reformat e policisë, situatën e kriminalitetit, realizime apo suksese të rëndësishme të policisë etj. Përgatitja e buletineve dhe publikimi i tyre për të prezantuar punën reale të kryer nga Policia e Shtetit është një nga masat e cila tregon transparencën e kësaj strukture dhe përmirëson imazhin e saj si dhe rrit besimin e qytetarëve të publiku. Gjithashtu, krahas publikimeve apo njoftimeve për shtyp për bërjen publike të ngjarjeve të veçanta, është i rëndësishëm edhe informimi periodik për bashkëpunimin me komunitetin dhe bashkëpunimin ndër-institucional në lidhje me çështjet e sigurisë.

Objektivi specifik 2.2. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve

Pavarësisht përcaktimeve ligjore në fuqi, bashkëpunimi ndërmjet strukturave vendore të policisë, pushtetit vendor dhe degëve vendore të institucioneve publike, nuk ka qenë në nivelin e

duhur dhe të pritshmërive. Policia e Shtetit është struktura që ka qenë e angazhuar maksimalisht, por ka pasur një reagim të vakët të institucioneve të tjera për të thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional. Strategjitë vendore të Sigurisë në Komunitet janë konsultuar rrallë me partnerët lokalë edhe në shumë pak raste partnerët lokalë kanë ndërmarrë hapa konkretë për rritjen e sigurisë publike, duke koordinuar veprimet me Policinë e Shtetit.

Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, si një mekanizëm koordinues, identifikues dhe menaxhues në nivel vendor mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit, janë të drejtuar nga Kryetari i Bashkisë. Ky mekanizëm përbën në vetvete një instrument të qëndrueshëm bashkëpunimi. Si një risi, e ndërmarrë që nga viti 2016⁵, ky mekanizëm është konceptuar të trajtojë çështjet e sigurisë duke garantuar të drejtat e njeriut dhe forcuar shtetin e së drejtës.

Në sajë të fuqizimit të bashkëpunimit ndërsektorial për sigurinë publike në nivel vendor duhet të përfshihen një sërë veprimesh, që synojnë:

- zgjerimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar mbi përcaktimin e kompetencave funksionale dhe procedurale në ngarkim të KVSP-ve, si dhe anëtarëve të përhershëm dhe vëzhgues, të cilët, ngarkohen të parët me të drejta dhe detyrime në zbatim të detyrës funksionale, ndërsa të dytët ftohen të angazhohen në format këshillues për shkëmbim informacioni ndërinstitucional;

- nxitjen e bashkëpunimit të institucioneve qendrore e në nivel vendor për t'u angazhuar me komunitetin, përfaqësuesit fetarë, organizatat e shoqërisë civile, si dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike;

- identifikimin dhe kuptimin e shqetësimeve socio-ekonomike, të komuniteteve lokale, në mënyrë që të bëhet i mundur trajtimi i shkaqeve rrënjësore mbi parandalimin, identifikimin, referimin dhe trajtimin e fenomeneve negative në dëm të qytetarëve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e çështjeve që lidhen me sigurinë lokale, si dhe në përballimin dhe rimëkëmbjen nga situatat që krijohen nga fatkeqësitë natyrore apo emergjenca civile të shkaktuara nga faktorë natyrorë, apo nga vetë njerëzit. Në përmbushjen e këtij objekti nevojitet krijimi i burimeve të mjaftueshme financiare për përballimin e situatave, si dhe ngritja dhe funksionimi i strukturave për menaxhimin e këtyre situatave, mobilizimi i publikut dhe vullnetarëve për trajtimin dhe eliminimin e pasojave, si dhe funksionimi i sistemeve paralajmëruese në komunitet, me qëllim shmangien apo minimizimin e rreziqeve.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht, nuk ka një akt ligjor ose nënligjor në fuqi, i cili të përcaktojë shprehimisht rolin e KVSP-ve, si dhe përfshirjen e komunitetit në fuqizimin e KVSP-ve. Në mënyrë që roli i KVSP-ve të jetë efektiv, kontributi i komunitetit në fuqizimin dhe bashkëveprimin me KVSP-të duhet të jetë i unifikuar në 61 bashkitë e vendit. Nuk kanë pasur asnjë efekt praktik dhe impakt në komunitetin e gjerë dhe gjenden ende larg pritshmërisë për të funksionuar si forume të diskutimit për çështjet e sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion.

Sfida më e madhe në forcimin e këtij mekanizmi janë aktet ligjore rregulluese dhe mirëfunksionimi i rregullt dhe periodik.

Megjithatë roli i njësitë të vetëqeverisjes vendore është fuqizuar, me hyrjen në fuqi të reformës territoriale, dhe këto struktura kanë një rol më aktiv gjatë viteve të fundit, do të ishte e nevojshme që roli i tyre të fuqizohej edhe më tej, duke krijuar struktura të posaçme për sigurinë në komunitet, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 (kompetencat e këshillit të bashkisë dhe kryetarit të bashkisë), si dhe të miratohet një buxhet i veçantë për funksionimin e këtyre strukturave në nivel bashkie dhe të njësitë administrative.

Treguesit e performancës:

⁵ Bashkia Elbasan është e para bashki që ndërmori krijimin e këtij mekanizmi koordinues, ku aktualisht janë të ngritur dhe konstituar 57 KVSP.

2.2.1 Krijimi i një modeli të unifikuar për funksionimin e KVSP-ve dhe zbatimi i KVSP-ve në të gjitha bashkitë e vendit;

2.2.2 Indeksi i funksionimit të KVSP-ve në 61 bashkitë e vendit;

2.2.3 Fuqizimi i strukturave të reja dhe i atyre ekzistuese, me qëllim fuqizimin e tyre për kompetencat dhe detyrat që duhen të ushtrojnë për sigurinë në komunitet;

2.2.4 Shtimi i investimeve për funksionimin e strukturave të vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e problematikave/situatave nëpërmjet burimeve të shtuara financiare.

Indikatorë të matshëm:

2.2.1.1 Dokumenti ligjor që përcakton në mënyrë të unifikuar funksionimin dhe mënyrën e zbatimit të KVSP-ve në të gjitha bashkitë e vendit;

2.2.2.1 Ngritja dhe bërja funksionale e KVSP-ve në çdo bashki të vendit deri në 2024;

2.2.3.1 Numri i udhëzimeve/urdhra që përcaktojnë dhe rishikojnë kompetencat dhe përgjegjësitë për secilin aktor;

2.2.4 Numri i investimeve të raportuara nga bashkia në përgjigje të çështjeve të sigurisë në komunitet të ngritura në KVSP.

Rezultate të pritshme:

2.2.1.1 Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve;

2.2.2.1.1 Numri i bashkive që raportojnë ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve;

2.2.2.1.2 Numri i Planveprimeve të KVSP-ve për fuqizimin e parametrave të sigurisë publike;

2.2.3.1.1 Numri i udhëzimeve/urdhra të dalë për përcaktimi i kompetencave dhe roleve të tjera të aktorëve përgjegjës, si: kryepelqë/kryetarët e lagjeve; strukturat pranë njësive administrative/bashkive dhe për administratorët e pallateve që normojnë veprimtarinë e këtyre aktorëve në këto fusha lidhur me evidentimin, adresimin dhe trajtimin e problematikave në fushën e sigurisë në komunitet;

2.2.3.1.2 Hartimi i udhëzimit/ urdhrit për rishikimin i rolit dhe përgjegjësi të policisë bashkiake;

2.2.4.1 Rritja e numrit të investimeve të raportuara nga bashkitë në përgjigje të çështjeve të sigurisë në komunitet të ngritura në KVSP.

Masa 12. Funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)

Hartimi i Plan Veprimeve të KVSP-ve për fuqizimin e parametrave të sigurisë publike në bashkëpunim me institucionet shtetërore në nivel vendor me Policinë e Shtetit. Funksionaliteti dhe performanca e KVSP-ve do të forcohet për të zyrtarizuar procesin, duke ndërtuar në uniformitet strukturën, procedurat, pikat e kontaktit dhe rezultatet. Kjo do të arrihet përmes krijimit të bazës ligjore dhe protokolleve të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit, si dhe një vizioni të qartë të kontributit të rëndësishëm që KSVP-të mund të japin në përmirësimin e sigurisë së të gjitha komuniteteve.

Institucionet përgjegjëse do të shkëmbejnë informacione në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe KVSP-të do të përdorin informacion për të siguruar inteligjencën më të mirë që do të mbështesë vendimet lokale dhe zgjidhjet e problemeve në partneritet, duke iu drejtuar për zbatim institucionit përgjegjës më të përshtatshëm për veprim.

Gjithashtu, do të synohet fuqizimi i rolit të aktorëve të tjerë vendorë për parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore, si dhe veprimeve të tjera të dhunshme, fuqizimi i këshillave të komuniteteve në lagje, vënia në funksion e vullnetarëve të policisë përmes përzgjedhjes, si dhe trajnimit dhe koordinimit të veprimtarisë në terren.

Masa 13. Fuqizimi i roleve të aktorëve të tjerë që kontribuojnë në sigurinë në komunitet

Gjithashtu, do të synohet fuqizimi i rolit të aktorëve të tjerë vendorë për parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore dhe veprimeve të tjera të dhunshme, si dhe fuqizimi i këshillave të komuniteteve në lagje, vënia në funksion e vullnetarëve të policisë përmes përzgjedhjes, trajnimit dhe koordinimit të veprimtarisë në terren.

Analiza e situatës dhe sfidat

Gjatë viteve të fundit, angazhimi i aktorëve/strukturave të tjera shtetërore apo të pushtetit vendor, për zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve ligjore në territor nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke ngarkuar më shumë strukturat e Policisë së Shtetit në këtë drejtim.

Si rrjedhojë, konsiderohet i domosdoshëm krijimi i strukturave të reja dhe fuqizimi i atyre ekzistuese, me qëllim zbatimin e kompetencave që përcaktohen nga ligji organik përkatës sipas fushëveprimit që mbulojnë, si p.sh: për krimet mjedisore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit, (mbrojtja e tokës, ajrit, ujërave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja e pyjeve/pemëve frutore e dekorative, mbrojtja e faunës dhe florës, etj. të cilat parashikohen nga ligji si vepra penale dhe janë përcaktuar kompetencat e aktorëve/institucioneve përkatëse dhe sanksionet ligjore ndaj shkelësve në ligjet përkatëse.

Rishikimi i akteve ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtyre aktorëve në këto fusha veprimi, me qëllim fuqizimin e tyre për kompetencat dhe atributet që duhen të ushtrojnë punonjësit e këtyre strukturave.

Gjithashtu duhet një fokus i veçantë sa i takon aktivizimit të disa strukturave që kanë qenë ndër vite si ato të grupeve të vullnetarëve në terren, organizimi dhe motivimi për dhënien e kontributit të tyre në fushën e mbrojtjes, parandalimit dhe goditjes së veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor do të vlerësohej i rëndësishëm.

Rishikimi apo hartimi i akteve të reja përkatëse (marrëveshje, memorandume, procedura pune etj.) të këtyre aktorëve/strukturave me strukturat ligjzbatuese në vend (polici, prokurori, etj.), me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor.

Objektivi specifik 2.3. Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike

Masa 14. Krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet

Vlerësohet si i nevojshëm planifikimi i buxhetit bashkiak për çështje që lidhen me sigurinë dhe rendin në komunitete, përfshirë çështje që lidhen me emergjencat civile, si dhe vendosja e pajisjeve monitoruese (teknologjike) nga institucionet vendore, për të ndihmuar në identifikimin dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe qytetarëve me rrezikshmëri shoqërore (në bashkërendim me Policinë e Shtetit), nën konceptin e *Smart Cities*.

Masa 15. Rishikimi i rolit dhe përgjegjësi të policisë bashkiake

Masat kyçe do të lidhen me rishikimin e ligjit për Policinë Bashkiake, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit.

Masa 16. Konsolidimi i strukturave të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike

Kjo masë synon unifikimin nëpërmjet hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të strukturës së KVSP-ve. Me hartimin e këtyre akteve, do të mundësohet krijimi i një baze ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillave të Sigurisë në mënyrë efektive, me qëllim konsolidimin e kësaj strukture në nivel vendor.

Në këtë kuadër do të realizohet:

- ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike;
- përmirësimi i kuadrit ligjor të funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja e të gjithë aktorëve institucionalë;
- përmirësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të brendshëm të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike;
- themelimi i rrjetit kombëtar të KVSP-ve dhe i një strukture të përhershme koordinuese të tyre;
- trajnimi i pjesëmarrësve të KVSP-ve mbi çështje të sigurisë në komunitet, si dhuna në familje, kriminaliteti, siguria në institucione arsimore parauniversitare përdorimi i lëndëve narkotike;

- përmirësimi i koordinimit mes KVSP-ve dhe strukturave të tjera lokale, përgjegjëse për menaxhimin e krizave, përfshirë katastrofat natyrore dhe kërcënimet për shëndetin publik (pandemitë), nëpërmjet hartimit të planeve të përbashkëta lokale;

- rritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në KVSP, nëpërmjet ndërmarrjes së fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit nga KVSP-të, lidhur me rreziqet e sigurisë në komunitet dhe informimin e publikut mbi rolin e të gjithë aktorëve lokalë institucionalë.

Masa 17. Rishikim i akteve ligjore për përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, hapjen e zyrave dhe shërbim të përhershëm të policisë në çdo bashki dhe njësi administrative

Kjo masë synon përmirësimin e kuadrit ligjor, me qëllim përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, si dhe krijimin e kushteve më të mira duke përdorur fonde nga donatorë dhe partnerë të tjerë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e pajisjeve logjistike për përmbushjen e detyrave.

Politika 3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet

Zbatimi i Strategjisë së Sigurisë në Komunitet kërkon ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në lidhje me reformimin e shërbimit policor, përmirësim organizativ dhe të kulturës së punës së vetë Policisë së Shtetit, në mënyrë që një grup vlerash thelbësore të udhëheqin mënyrën e ofrimit të shërbimit ndaj komunitetit dhe të bëhen promotor i rritjes së standardeve të punës.

Përmirësimi organizativ përfshin integrimin e filozofisë së sigurisë në komunitet në veprimtarinë e Policisë së Shtetit, në misionin, politikat, planifikimin dhe procedurat, vlerësimin e performancës, trajnimin, praktikën e rekrutimit dhe zhvillimit të karrierës, në sistemet dhe metodat e sigurisë që përcaktojnë kulturën organizative dhe veprimtarinë e saj.

Përmirësimi organizativ synohet të arrihet edhe nëpërmjet krijimit të strukturave të specializuara të implementimit dhe integritetit të kësaj strategjie në veprimtarinë e gjithë shërbimeve policore. Në fokus do të jetë rishikimi i funksioneve, përmirësimi i strukturave dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe mirëqenies së punonjësve të policisë si në aspektin logjistik, infrastrukturës, po ashtu dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale. Kjo politikë ka në fokus dy objektiva specifike kryesore:

Objektivi specifik 3.1

Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet.

Objektivi specifik 3.2

Përmirësimi i kushteve të punës, performancës, kapaciteteve profesionale dhe motivimit të punonjësve të policisë.

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet

Përmirësimi i strukturave të policimit në komunitet veçanërisht, përmirësimi i funksionit të ndihmës specialistit të policimit në komunitet NSPK/SPZ të zonës policore (pasi policim në komunitet kryejnë të gjitha strukturat e PSH-së) ka të bëjë me faktin që ky funksion të jetë i veçantë vetëm për policimin në komunitet (për kryerjen e aktiviteteve me fokus komunitetin dhe forcimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në zonën policore), duke mos pasur më rol “represiv” siç funksionon aktualisht, ku ka edhe përgjegjësi të tjera si: kontrollë banesash, shoqërimi/ndalime personash, ndërhyrje dhe pjesëmarrje në operacione policore, kapjen e personave në kërkim, kontrollë territori për kanabis etj.

Gjithashtu, bazuar në situatën aktuale të strukturës vendore organike të policimit në komunitet rezulton se në zonat rurale, numri i NSPK/SPZ-ve është i pamjaftueshëm për të mbuluar territorin dhe për të realizuar detyrat e përgjegjësitë funksionale, pra rrjedhimisht është e

nevojshme të konsiderohet mundësia e rritjes së kapaciteteve të punonjësve të policimit në komunitet në zonat rurale, të paktën edhe me një punonjës shtesë brenda zonës policore (1 SPZ dhe një ndihmës i tij = patrullë policie), pasi në të gjitha zonat urbane funksionon patrulla e përgjithshme të policisë, ndërsa në zonat policore rurale nuk ka punonjës të patrullës së përgjithshme.

Si përfundim, përmirësimi i strukturave të policimit në komunitet synon:

- funksion/strukturë të veçantë vetëm për policimin në komunitet;
- rritjen e kapaciteteve të punonjësve të policimit në komunitet në zonat rurale.

Gjithashtu, do të nevojitet përcaktimi i objektivave afatshkurtër për njësitë e vetëqeverisjes vendore për miratimin e strukturës, përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe përcaktimin e një buxheti për Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht në strukturat vendore të PK ushtrohen funksionet e NSPK/SPZ të zonës policore dhe NSPK/SPZ për edukimin dhe punën me të rinjtë.

Sa i përket funksionit organik të NSPK/SPZ për edukimin dhe punën me të rinjtë është e nevojshme të shtohet si funksion edhe në komisarariatet e tjera të policisë, duke vlerësuar edukimin me të rinjtë si një element kyç për parandalimin, ndërsa për funksionin organik të NSPK/SPZ të zonës policore është e domosdoshme që funksioni të jetë i veçantë vetëm për policimin në komunitet (për kryerjen e aktiviteteve me fokus komunitetin dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët e tjerë në zonën policore) dhe jo siç funksionin aktualisht, ku ka edhe përgjegjësi të karakterit represiv si: kontrolle banesash, shoqërime/ndalime personash, ndërhyrje dhe pjesëmarrje në operacione policore, kapja e personave në kërkim, kontrolle për kanabis etj.

Krahas strukturave të Policisë së Shtetit për shërbimin ndaj komunitetit, në territor janë edhe shumë aktorë/struktura të tjera shtetërore dhe jo vetëm, të cilat kërkojnë përmirësim dhe fuqizim të tyre për realizimin sa më mirë të përgjegjësi dhe detyrimeve që kanë ndaj komunitetit, pa përjashtuar përfshirjen edhe të organizatave joqeveritare dhe komunitetet fetare që operojnë në territor.

Treguesit kryesorë të performancës:

3.1.1 Fuqizimi i kapaciteteve policore në shërbim të komunitetit;

3.1.2 Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të zonës policore në Akademinë e Sigurisë.

Indikatorë të matshëm:

3.1.1.1 Rritja e numrit të NSPK/SPZ me funksion në shërbim të komunitetit;

3.1.1.2 Numri i punonjësve të policisë në komunitet në raport me popullsinë;

3.1.1.3 Numri i punonjësve sipas strukturës dhe funksioneve të përcaktuara në sektorin e planifikimit, monitorimit dhe analizës strategjike në nivel vendor e qendror;

3.1.2.1 Numri i trajnimeve të kryera;

3.1.2.2 Numri i punonjësve të trajnuar.

Rezultate të pritshme:

3.1.1.1.1 Rritja e numrit të punonjësve në zonat rurale;

3.1.1.1.1 Ulja e numrit të ankesave, konflikteve dhe problematikave të çështjeve që shqetësojnë komunitetin, etj.;

3.1.2.1.1 Rritja e trajnimeve me tema që mbulojnë çështje policore në shërbim të komunitetit;

3.1.2.2.1 Rritja e numrit të punonjësve të trajnuar sipas çështjeve që mbulojnë në funksione;

3.1.2.2.2 Rritja e numrit të grave të punonjësve të PSH-s të trajnuara, sipas çështjeve që mbulojnë në funksione.

Masa 18. Fuqizimi i burimeve njerëzore

Masat do të lidhen me ofrimin e sigurisë në komunitet nëpërmjet fuqizimit të burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit në funksion të policimit në komunitet, nëpërmjet krijimit të një strukture të dedikuar për policimin në Komunitet, përmirësimit dhe shtrirjes së plotë të

funksionimit të zonave policore, si dhe implementimi i ndryshimeve të funksioneve të reja të NSPK-ve dhe strukturave të tjera të ZP-ve.

Orientimi për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në komunitet kërkon një vëmendje të veçantë në aftësitë analitike dhe menaxhimin e sistemeve nga ekspertët për të marrë mbështetjen më të vlefshme të informacionit. Në fokus do të jetë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i strukturave të sektorit të planifikimit, monitorimit dhe analizës strategjike në çdo Drejtori Vendore të Policisë dhe në nivel qendror.

Roli i oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare do të rishikohet me rigorozitet për të siguruar uniformitetin e rolit dhe përgjegjësi në të gjithë Shqipërinë dhe për të siguruar arritjen e praktikave më të mira.

PSH-ja do të rekrutojë, trajnojë dhe caktojë oficerë të përkushtuar dhe me integritet të policimit në komunitet në zonat policore, si dhe do të ofrojë mbështetje për të siguruar forcimin e kapaciteteve të punonjësve, si dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Masa 19. Rritja e kapaciteteve

Kjo masë synohet të realizohet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të punonjësve, duke ofruar trajnim dhe kualifikime, me fokus përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të zonës policore në Akademisë së Sigurisë. Gjithashtu, marrjen e masave të ndryshme të lidhura me trajnimin e punonjësve të policisë në funksione dhe detyra të ndryshme, si dhe përmirësimin e kurrikulave e ofrimin e trajnimeve periodike për NSPK-të, patrullën e përgjithshme dhe aktorëve relevantë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë.

Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta midis punonjësve të policisë dhe aktorëve të tjerë shtetërorë e privatë që operojnë në “zonën policore”, me fokus ndarjen/ marrjen e përgjegjësi/detyrimeve ligjore që ka secili në fushën e sigurisë publike, por edhe për rritjen e bashkëpunimit e ndërveprimit për parandalimin e veprimtarisë kriminale, paligjshmërisë dhe sjelljeve antishoqërore në territor, konstatimin, evidentimin dhe ndëshkimin e tyre konform akteve ligjore në fuqi.

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë

Në fokus do të jenë masat që do të përmirësojnë përgjegjshmërinë, kontrollin dhe performancën e punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe vendor, të cilat do të përmirësojnë rekrutimin, zhvillimin dhe karrierën (përfshirë masat për angazhimin e grave apo grupeve minoritare), si dhe masat që garantojnë cilësinë e kushteve të punës dhe mirëqenien e punonjësve të lidhura me infrastrukturën, pajisjet, mjetet, uniformën, teknologjinë, etj. Ndërhyrjet gjithashtu do të sigurojnë prezantim dinjitoz para komunitetit i punonjësve të zonës policore për policim në komunitet, si dhe dhënia e të drejtave të përcaktuara me ligj dhe nxitja për kryerjen sa më mirë të detyrave në fushën e policimit në komunitet

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht, strukturat vendore të PK-s janë të organizuara mbi bazën e “Zonës Policore”, të ndara në zona policore urbane dhe zona policore rurale. Kryesisht, kushtet e punës në zonat urbane vlerësohen të mira, ndërsa në zonat rurale ka nevojë për krijimin e ambienteve të punës për punonjësit e policisë të “Zonës Policore”, si dhe përmirësimin e kushteve në ato ambiente ekzistuese, duke marrë masa të plota për kompletimin e zyrave të punës me infrastrukturën e nevojshme për punë dhe për pritjen e qytetarëve si; tavolina, karrige, kompjuterë, printer, linjë interneti, pajisje për ngrohje/ftohje etj.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe motivimi për punonjësit e policisë të “Zonës Policore”, si dhe kompletimi i tyre me automjet për lëvizje dhe pajisje policie, vlerësohet i rëndësishëm, pasi do të bëjë të mundur shfrytëzimin në mënyrë eficiente të kohës së punës në zonën policore, ndjekjen më nga afër të problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit, si dhe parandalimin në kohë të ngjarjeve të mundshme apo veprave penale.

Treguesit kryesorë të performancës

3.2.1 Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e policisë të “Zonës Policore”;

3.2.2 Përmirësimi i masave motivuese për kryerjen sa më të mirë të shërbimit të punonjësve të policisë të “Zonës Policore”.

Indikatorë të matshëm:

3.2.1.1 Numri i hapjes së zyrave të reja në zonën policore;

3.2.1.2 Numri i zyrave policore të rikonstruktura;

3.2.1.3 Numri i zyrave policore të pajisura me infrastrukturë për punë;

3.2.2.1 Numri i punonjësve të policisë të zonës policore pajisur me automjete shërbimi;

3.2.2.2 Numri i specialistëve të policimit në komunitet NSPK/SPZ, që marrin gradën “Inspektor i parë” për ndihmës bazuar në Ligjin për Policinë e Shtetit;

3.2.2.3 Numri i orëve suplementare të paguara për punonjësit e policimit në komunitet mbi kohën normale të punës;

3.2.2.4 Vendosja e një shenje të veçantë dalluese për punonjësit e policimit në komunitet NSPK/SPZ dhe numri i punonjësve të identifikuar me shenjën dalluese;

3.2.2.5 Numri i punonjësve të pajisur me uniforma të reja policore.

Rezultate të pritshme:

3.2.1.1 Rritja e numrit të zyrave policore me infrastrukturën e nevojshme për punë dhe për pritjen e qytetarëve;

3.2.2.1.1 Kompletimi i të gjithë punonjësve të policisë të zonës policore me automjete shërbimi (kryesisht në zonat rurale) për të motivuar dhe lehtësuar realizimin e detyrave funksionale;

3.2.2.1.2 Rritja e numrit të automjeteve të shërbimit në dispozicion të punonjësve të policisë të zonës policore;

3.2.2.2 Rritja e numrit të specialistëve të policimit në komunitet NSPK/SPZ, që marrin gradën “Inspektor i parë” për ndihmës, bazuar në Ligjin për Policinë e Shtetit;

3.2.2.3 Barazimi i numrit të orëve suplementare të paguara për punonjësit e policimit në komunitet me kohën suplementare të punës;

3.2.2.4 Rritja e numrit të punonjësve të policimit në komunitet NSPK/SPZ të identifikuar me shenjën dalluese;

3.2.2.5 Rritja e numrit të punonjësve të pajisur me uniforma të reja policore, duke i dhënë një paraqitje dinjitoze punonjësve përballë komunitetit/publikut.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmblotjes së masave të mëposhtme:

Masa 20. Krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me drejtuesit e pushtetit vendor dhe të institucioneve të tjera shtetërore, me qëllim gjetjen e ambienteve sa më të përshtatshme të cilat mund të përdoren nga punonjësit e “Zonës policore” kryesisht nga punonjësit e policimit në komunitet. Këto ambiente/zyra duhen të jenë sa më afër qendrave të njësive administrative që bëjnë të mundur ofrimin e lehtësirave për qytetarët dhe të qenurit më të aksesueshme për ta.

Masa 21. Rikonstruksioni i zyrave ekzistuese në zonat policore urbane dhe rurale

Drejtuesit e strukturave vendore të PSH duhet të kryejnë vlerësimin e ambienteve/zyrave aktuale të shërbimit policor pranë njësive administrative në zonat urbane dhe rurale, me qëllim evidentimin e gjendjes së tyre aktuale, përcaktimin e zyrave që kanë nevojë për rikonstruksion dhe planifikimin/buthtimin e marrjen e masave për rikonstruksionin e tyre, duke shfrytëzuar burimet financiare e materiale që disponojnë, si dhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në juridiksionin territorial të njësive policore.

Masa 22. Kompletimi me infrastrukturë për punë i zyrave në zonat policore urbane dhe rurale, me uniformë dinjitoze dhe mjete e pajisje policie

Drejtuesit e strukturave vendore të PSH-së duhet të kryejnë vlerësimin e ambienteve/zyrave aktuale të shërbimit policor pranë njësive administrative në zonat urbane dhe rurale dhe të atyre të hapura të reja, duke evidentuar nevojat që këto zyra kanë për t’u bërë funksionale dhe me parametra të pranueshëm pune.

Mbi bazën e nevojave do të merren edhe masat përkatëse për kompletimin dhe pajisjen e tyre me infrastrukturën e nevojshme për punë (tavolina, karrige, kompjuter, printer, internet, kasafortë, rafte, pajisje ngrohje/ftohje, etj.), për pritjen e qytetarëve dhe trajtimin e shqetësimeve e problematikave të tyre, si dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës, duke shmangur sorollatjet e qytetarëve dhe lëvizjet boshe të NSPK/SPZ-ve nga zona në njësinë policore e anasjelltas. Për këtë qëllim, duhen shfrytëzuar burimet financiare e materiale që kanë strukturat vendore të policisë, por edhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në juridiksionin territorial të njësisë policore.

Masa 23. Motivimi i punonjësve të policisë të zonës policore

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet rishikimit të mundësive për rritjen e pagave për punonjësit e policisë, nëpërmjet propozimeve dhe diferencimeve të pagave mes strukturave e funksioneve të ndryshme që janë pjesë e “zonës policore”.

Gjithashtu, vlerësohen shumë të rëndësishëm ndërmarrja e hapave të mëposhtëm, për motivimin e punonjësve të zonës policore, e në veçanti të punonjësve të policimit në komunitet:

- dhënia e gradës “Inspektor i parë” për ndihmës specialistët e policimit në komunitet NSPK/SPZ, bazuar në ligjin për Policinë e Shtetit;

- pagesa e orëve suplementare të kryera nga punonjësit e policimit në komunitet mbi kohën normale të punës;

- vendosja e një shenje të veçantë dalluese për punonjësit e policimit në komunitet NSPK/SPZ, dhe pajisja me uniforma të reja policore, duke i dhënë një paraqitje dinjitoze këtyre punonjësve përballë komunitetit/publikut;

- kompletimi i punonjësve të policisë të zonës policore me automjete shërbimi (kryesisht në zonat rurale) për të motivuar dhe lehtësuar realizimin e detyrave funksionale.

PJESA III – MASAT PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË

Bazuar në objektivat specifike të parashikuara në këtë dokument strategjik, me qëllim përmbushjen e tyre, ndër masat prioritare përmendim, si më poshtë:

- forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese;

- realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike

- parandalimi nëpërmjet edukimit;

- përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit;

- funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP);

- krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet;

- fuqizimi i burimeve njerëzore;

- krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale.

Disa prej këtyre masave synohen të realizohen nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, por gjithashtu të mbështetura edhe në donatorë, të cilët kanë programuar disa zëra në buxhetet e tyre.

Programi “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri” (**SCPA**), i cili financohet nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida), është një nga donatorët, i cili mbështet edhe disa masave specifike në këtë dokument. Sa i përket masës “Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike” është parashikuar të mbështetet nga programi suedez SCPA për realizimin e SMSK-ve, anketimeve, intervistave, pyetësorëve mbi kënaqësinë publikut te Policia e Shtetit dhe institucionet, i cili ka parashikuar fonde për kryerjen e anketës kombëtare për kënaqësinë e publikut me punën e Policisë për vitin 2022, anketës për Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet (Elbasan dhe Kukës).

Gjithashtu, në lidhje me masën “Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit”, ky program ka parashikuar një fond të posaçëm për blerjen e pajisjeve për policinë rrugore (tableta, radarë). Kostot e parashikuara nga ky program për realizimin e këtyre masave, por edhe komponentëve të tjerë janë përfshirë në aneksin e Planit të Veprimt.

PJESA IV – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e Strategjisë në Komunitet dhe Planin e Veprimit janë:

- Ministria e Brendshme;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Ministrinë e linjës ku përfshihen ministrinë e ngarkuara me zbatimin e këtij dokumenti, që ngarkohen për masa/aktivitete specifike sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;
- Institucionet shtetërore: institucione të varësisë së ministrive të linjës të ngarkuara në dokument.

Pushteti vendor

- Prefektët e qarqeve;
- Këshillat Vendorë të Sigurisë publike;
- Kryetarët e këshillave të qarqeve;
- Kryetarët e bashkive;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet arsimore parauniversitare;
- Institucionet e tjera të linjës - institucione të pushtetit vendor;
- Shoqata të ndryshme në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të njeriut, gruas, fëmijëve, minoriteteve dhe komuniteteve;
- OJF-të me aktivitet në këtë fushë në Shqipëri;
- Media kombëtare dhe lokale, si dhe çdo grup apo individ i interesuar etj.

Roli specifik i bashkive në kuadër të sigurisë në komunitet në nivel vendor

Siç është shprehur dhe në analizën e kësaj strategjie, angazhimi i aktorëve/strukturave të tjera shtetërore apo të pushtetit vendor, për zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve ligjore në territor nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke ngarkuar më shumë strukturat e Policisë së Shtetit në këtë drejtim. Po kështu, me hyrjen në fuqi të reformës territoriale, roli i njësive të vetëqeverisjes vendore është fuqizuar dhe këto struktura kanë pasur një rol më aktiv gjatë viteve të fundit, por do të synohet fuqizimi i rolit të tyre edhe më tej, duke krijuar struktura të posaçme për sigurinë në komunitet, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 (kompetencat e këshillit të bashkisë dhe kryetarit të bashkisë), si dhe mundësimin e miratimit të një buxheti i të veçantë për funksionimin e këtyre strukturave në nivel bashkie dhe të njësive administrative.

4.2 Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Përjasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS”.

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

- Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);
- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë së Sigurisë në Komunitet do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit mbi Sigurinë në Komunitet do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë në komunitet (përfshirë MB/DPPSH, MASR, MSHMS, bashkitë – AMVV, KVSP-të), Donatorë dhe shoqërinë civile, (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së objektivave strategjike të sigurisë në komunitet, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve;
- monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikën e vendit të lidhura me sigurinë në komunitet. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/ të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale së Sigurisë në Komunitet dhe Planin e Veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe një vjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6 mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatit Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial “punët e brendshme”, drejtuar nga ministri i Brendshëm, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të urdhrin të kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioritetëve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Krahas monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet do të matet nëpërmjet vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të tre-vjeçarit, në fund të vitit 2023, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për vitet 2024 – 2026 për të arritur objektivat e vendosur në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të sigurisë në komunitet. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit, si dhe raporte e studime të kryera nga shoqëria civile dhe donatorët.

PJESA V - BUXHETI

Efektet financiare përllogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023, në mënyrë të detajuar.

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë së Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026. Efektet financiare janë përllogaritur nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023, në mënyrë të detajuar.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Plani i Veprimit 2021 – 2023 është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë në përmbushje të objektivave specifike.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit është 7,760,392,246 lek, ose 62, 083,138 euro. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 125 lek për 1 euro.


Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kosto totale	Kosto e planifikuar në	Kosto për t'u planifikuar në	Hendeku financiar
		2021 – 2026	PBA 2021 – 2023 Buxheti dhe donatorët	PBA 2022 – 2024 Buxheti dhe donatorët	2021 – 2026
QP1: Rritja e parametrave të sigurisë	Korente	2,528,523,430	1,666,502,610	862,020,820	0
	Kapitale	531,840,000	35,000,000	496,840,000	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	774,098,816	613,508,816	160,590,000	0
	Kapitale	0	0	0	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve	Korente	3,819,680,000	1,622,140,000	1,816,900,000	454,390,000

për sigurinë në komunitet	Kapitale	106,250,000	5,000,000	27,500,000	
TOTALI [lekë]		7,760,392,246	3,942,151,426	3,363,850,820	454,390,000
TOTALI [euro] <i>1 euro = 125 lekë</i>		62,083,138	31,537,211	26,910,807	3,635,120

Qëllimi i Politikës 3, pritet të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e planit, përafërsisht në masën 51 %. Ndërsa qëllimi i politikës 1 dhe qëllimi i politikës 2 zënë përafërsisht përkatësisht 39 % dhe 10% në totalin e buxhetit të Planit të Veprimit.


Financimi i planit të veprimit të strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2021 – 2023, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit përafërsisht në masën 50 % të financimit të nevojshëm, ndërsa 1% pritet të financohet nga donatorë të tjerë. Hendeku financiar vlerësohet të jete në masën përafërsisht 6 % të totalit të kostos financiare të gjithë viteve të strategjisë, e cila është hartuar mbi bazë supozimi që kostoja financiare pas vitit 2023, pritet të financohet nga PBA 2022 – 2024 e në vazhdim dhe donatorët.

Natyrat ekonomike e kostove të Planit të Veprimit



Peshën më të madhe për zbatimin e masave të Planit të Veprimit e zënë kostot korente, përkatësisht në masën 92 %. Ndërsa kostot kapitale përllogariten në masën 8 % të kostos totale të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026.

Kostot korente dhe kapitale të lidhur sipas qëllimit të politikave janë si më poshtë:



Plani i Veprimit të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet do të rishikohet në periudhë 3-vjeçare për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform programeve buxhetore afatmesme, si dhe prioriteteve të çdo institucioni. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor.

Qëllimi i politikës I: Rritja e parametrave të sigurisë																		
Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021 – 2026 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimor 1 EUR = 125 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA			Financimi i huaj			Buxheti total				
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektiv specifik 1.1 Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin	DPPSH	KVSP; Bashkia; Institucioni i Prefektit Institucionet shtetërore; Shoqëria civile; Komiteti Programi SCPA; Shoqëria civile; QJF	2021	2023	700,450,000	145,000,000	845,450,000	372,650,000	0	372,650,000	0	0	0	327,800,000	145,000,000	472,800,000	0	6,763,600
Objektiv specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet	DPPSH; ASCAP	KVSP; NJVV; Institucionet e tjera të linjës; SCPA; DPAP; MASR; SHSSH; ASHMDIF; ISHP; NJVKS; DRSHSSH	2021	2023	1,542,261,916	0	1,542,261,916	1,002,416,096	0	1,002,416,096	5,625,000	0	5,625,000	534,220,820	0	534,220,820	0	12,338,095
Objektiv specifik 1.3 Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit	NJVV; AMVV; DPPSH/DVP;MSHMS	NJVV; MKR OSHC e specializuara; Donatorët(SCPA); Institucionet shtetërore në nivel vendor; DPPSH-DVP	2021	2023	285,811,514	386,840,000	672,651,514	283,656,714	10,000,000	293,656,714	2,154,800	25,000,000	27,154,800	0	351,840,000	351,840,000	0	5,381,212
Kosto totale qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)					2,528,523,430	531,840,000	3,060,363,430	1,658,722,810	10,000,000	1,668,722,810	7,779,800	25,000,000	32,779,800	862,020,820	496,840,000	1,358,860,820	0	24,482,907
Qëllimi i politikës II: Angazhim dhe ndërrëprimi me komunitetin																		
Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021–2026	Kosto totale në EUR

	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA			Financimi i huaj			Buxheti total			(në lekë)	(kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektivi specifik 2.1 Përmirësimi i komunikimit me publikun	DPPSH-DVP; MSHMS; MB; NJVV	ASCAP/MASR; Ministritë e linjës; NJVV; KVSP; MKR OSHC e specializuara; Donatorët; MB/PSH; Akademia e Sigurisë;	2021	2026	411,034,988	0	411,034,988	248,053,388	0	248,053,388	2,391,600	0	2,391,600	160,590,000	0	160,590,000	0	3,288,280
Objektivi specifik 2.2 Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve	MSHMS; MB; AMVV; NJVV	Institucionet anëtare të KVSP;MKR/NJMF; OSHC e specializuara; Donatorët; Ministritë e linjës; Komunitetet fetare; Shoqëria civile; Media; Biznesi	2021	2026	180,773,628	0	180,773,628	178,618,828	0	178,618,828	2,154,800	0	2,154,800	0	0	0	0	1,446,189
Objektivi specifik 2.3 Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike	NJVV - KVSP/AMVV; MB	NJVV/AMVV	2021	2026	182,290,200	0	182,290,200	182,290,200	0	182,290,200	0	0	0	0	0	0	0	1,458,322
Kosto totale qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)					774,098,816	0	774,098,816	608,962,416	0	608,962,416	4,546,400	0	4,546,400	160,590,000	0	160,590,000	0	6,192,791
Qëllimi i Politikës III: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet																		
Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021 – 2026 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA			Financimi i huaj			Buxheti total				
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektivi specifik 3.1 Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet	DPPSH; MB	Akademia e Sigurisë; Programi SCPA; MASR; NJVV - KVSP	2020	2030	2,094,133,000	0	2,094,133,000	708,624,000	0	708,624,000	0	0	0	1,385,509,000	0	1,385,509,000	0	16,753,064
Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë	DPPSH - DVP; MB; Programi SCPA (donatorë)	NJVV/Njësitë Administrative Institucionet e tjera; Donatorët	2020	2030	1,725,547,000	106,250,000	1,831,797,000	907,891,000	0	907,891,000	5,625,000	5,000,000	10,625,000	431,391,000	27,500,000	458,891,000	-454,390,000	14,654,376
Kosto totale qëllimi i politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2)					3,819,680,000	106,250,000	3,925,930,000	1,616,515,000	0	1,616,515,000	5,625,000	5,000,000	10,625,000	1,816,900,000	27,500,000	1,844,400,000	-454,390,000	31,407,440
Kosto totale e Planit të Veprimit					7,122,302,246	638,090,000	7,760,392,246	3,884,200,226	10,000,000	3,894,200,226	17,951,200	30,000,000	47,951,200	2,839,510,820	524,340,000	3,363,850,820	-454,390,000	62,083,138

Kosto totale e Planit të Veprimit	7,760,392,246
PBA 2021–2023	3,894,200,226
Financimi i huaj	47,951,200
Buxheti 2024–2026	3,363,850,820
Hendeku financiar 2021–2026	454,390,000

	Kosto Korente	Kosto kapitale	TOTALI
Qëllimi i politikës I	2,528,523,430	531,840,000	3,060,363,430
Qëllimi i politikës II	774,098,816	0	774,098,816
Qëllimi i politikës III	3,819,680,000	106,250,000	3,925,930,000

Kosto Korente	7,122,302,246
Kosto kapitale	638,090,000
Totali i kostos	7,760,392,246

Nevojat kapitale (në Lek)

Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kosto totale	Kosto e planifikuar në	Kosto për t'u planifikuar në	Hendeku financiar
		2021–2026	PBA 2021–2023	PBA 2022–2024	2021–2026
			Buxheti dhe donatorët	Buxheti dhe donatorët	
QP1: Rritja e parametrave të sigurisë	Korente	2,528,523,430	1,666,502,610	862,020,820	0
	Kapitale	531,840,000	35,000,000	496,840,000	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	774,098,816	613,508,816	160,590,000	0
	Kapitale	0	0	0	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet	Korente	3,819,680,000	1,622,140,000	1,816,900,000	454,390,000
	Kapitale	106,250,000	5,000,000	27,500,000	
TOTALI [lekë]		7,760,392,246	3,942,151,426	3,363,850,820	454,390,000
TOTALI [euro]		62,083,138	31,537,211	26,910,807	3,635,120

1 euro = 125 lekë

